

**Pettifer: Pas Hagës,
Kosova duhet ta rishikojë
raportin me misionet
ndërkombëtare**

FAÇE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

QENDRA "GJENOCIDI NË KOSOVË - PLAGË E HAPUR" KËRKON MEMORANDUM
PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME NË VEND

BARDHYL MAHMUTI: ZHBËRJA E DHOMAVE TË SPECIALIZUARA, DOMOSDOSHME RI HISTORIKE PËR TË SHMANGUR RREZIKUN QË I KANOSËT KOSOVËS

FAÇE 4-5



Kryetari i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", Bardhyl Mahmuti, ka kërkuar mobilizimin e të gjitha partive politike dhe veprim institucional pas aktgjykimit të 16 shtatorit të Dhomave të Specializuara në Hagë. Gjatë një

konferencë për media të martën në Prishtinë, ai ka prezantuar një memorandum, përmes të cilit kërkon nga udhëheqësit e shtetit të Kosovës që të shpallin gjendje të jashtëzakonshme në vend, pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së.

Mahmuti ka theksuar se dënimi ishte politik dhe ka kërkuar që institucionet dhe subjektet politike të reagojnë në mënyrë të koordinuar, me qëllim arritjen e një konsensusi për zhbërjen e Dhomave të Specializuara

OPINION

**REAGIM SHTETËROR NDAJ
AKTGJYKIMIT TË DHOMAVE
TË SPECIALIZUARA
TË KOSOVËS** F. 7

Shkruan: Akademik
Arsim BAJRAMI



AKTUALE



**FSK-ja AVANCON KAPACITETET
TEKNIKE PËR MIRËBAJTJEN E
AUTOMJETEVE HMMWV ME
MBËSHTETJEN AMERIKANE** F. 8

**SHQIPËRIA I BASHKOHET NISMËS
AMERIKANE PËR EKSPLOKIMIN E
HAPËSIRËS** F. 8

EKONOMI

**DHTIK KËRKON MASA LEHTËSUESE
PËR BIZNESET DHE FERMERËT NGA
RRITJA E ÇMIMEVE TË DERIVATEVE** F. 9

**KURTI TAKON DREJTORESHËN
MENAXHUESE TË FMN-SË,
DISKUTOJNË PËR BASHKËPUNIMIN** F. 9

SPORT



**KOMBËTARJA E KOSOVËS NIS
PËRGATITJET PËR LIGËN E
KOMBEVE ME MESAZH TË FUQISHËM:
DREJTËSI PËR ÇLIRIMTARËT** F. 11

**MË 1 TETOR ORGANIZOHET
MARSHI "JO NË EMRIN TIM"**



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SULMI RUS VRET 4 PERSONA NË DNJEPËR, NDËRSA ZELENSKY PRITET TË TAKOHET ME TRUMPIN



KIEV, 22 SHTATOR - Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka mbërritur në Nju Jork për të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, ndërsa Rusia ka kryer një sulm me raketa dhe dronë ndaj Ukrainës, duke vrarë të paktën katër persona në Dnjepër. “Janë planifikuar rreth 20 takime, përfshirë me presidentin e SHBA-së, liderë evropianë, senatorë amerikanë dhe anëtarë të Dhomës së Përfaqësuesve, drejtues të organizatave ndërkombëtare, kompanive kryesore amerikane dhe grupeve të ekspertëve”, shkroi Zelensky në X pas mbërritjes në Nju Jork, ku pritet t’i drejtohet sesionit të 81-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

Zelensky pritet të takohet me presidentin amerikan, Donald Trump, në orën 13:15 sipas kohës lokale, në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, më 22 shtator. Në një postim në rrjetet sociale, Zelensky tha se takimi “mund të ndryshojë shumë gjëra” dhe se ai dhe Trumpi “kanë kaluar nëpër shumë gjëra” gjatë diskutimeve të tyre. Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, pritet gjithashtu të jetë në Nju Jork dhe më 23 shtator pritët të takohet me sekretarin amerikan të Shtetit, Marco Rubio. Zelensky u takua gjithashtu me presidentin francez, Emmanuel Macron, në Nju Jork. Ata diskutuan për sigurinë dhe pakon e mbështetjes për Ukrainën gjatë dimrit, ndërsa

Kievi po kërkon sisteme dhe raketa shtesë të mbrojtjes ajrore përmes fondeve të huasë së Bashkimit Evropian. Ndërkohë, sipas Reuters dhe Financial Times, duke cituar burime, Zelensky u takua me drejtorin e CIA-s, John Ratcliffe, në aeroportin Shannon të Irlandës, gjatë rrugës së tij për në Nju Jork. Një burim e përkroi takimin si “të shkurtër, të paplanifikuar dhe joformal”, duke vënë në dukje se të dy po bënin ndalesa për furnizim me karburant dhe se Ratcliffe po kthehej në Shtetet e Bashkuara nga Egjipti. Takimi i Ratcliffe me Zelenskyn vjen më pak se një muaj pasi shefi i CIA-s udhëtoi në Moskë për t’u takuar me zyrtarët kryesorë të inteligjencës ruse.

SPANJA MUND TA PENGJOJË INTEGRIMIN E MALIT TË ZI NË BE

MADRID, 22 SHTATOR - Spanja mund të bëhet një pengesë e papritur në rrugën e Malit të Zi drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), për shkak të agjendës së brendshme politike të Madridit. Qeveria spanjolle tani po e lidh drejtpërdrejt çështjen e njohjes së katalanishtes, baskishtes dhe galicishtes si gjuhë zyrtare të BE-së me zgjerimin e ardhshëm të bllokut evropian. Madridi këmbëngul që statusi i këtyre tri gjuhëve të zgjidhet para se, me anëtarësimin e shteteve të reja, BE-së t’i shtohen gjuhë të tjera zyrtare. Në mesin e vendeve kandidatë, Mali i Zi është aktualisht më afër anëtarësimit. Edhe pse Madridi zyrtarisht nuk ka thënë se do ta bllokojë zgjerimin, deklaratat e zyrtarëve spanjollë lënë të hapur pyetjen nëse çështja e gjuhëve mund të bëhet kusht për përparimin e procesit të zgjerimit. “Është koha që, 40 vjet pasi Spanja iu bashkua Bashkimit Evropian, t’i jepet fund diskriminimit ndaj të cilit janë të ekspozuar 20 milionë spanjollë, ose 20 milionë evropianë që jetojnë në territore me më shumë se një gjuhë zyrtare, në krahasim me evropianët e tjerë që gjithashtu kanë më shumë se një gjuhë zyrtare”, tha në Bruksel sekretari shtetëror spanjoll për Çështjet Evropiane, Fernando Sampedro Marcos. Ministri i Jashtëm spanjoll, Hoze Manuel Albares, në vitin 2023 i kishte dorëzuar zyrtarisht Këshillit të BE-së propozimin që katalanishtja, baskishtja dhe galicishtja të njihen si gjuhë zyrtare të Bashkimit Evropian. Tani Madridi këmbëngul që çështja e këtyre tri gjuhëve të zgjidhet para valës së ardhshme të zgjerimit, pra para se numri i gjuhëve zyrtare të BE-së të rritet me pranimin e anëtarëve të rinj. Spanja njëkohësisht thekson se e

mbështet zgjerimin dhe përparimin e vendeve kandidatë, por kërkon që kërkesa e saj të zgjidhet para se anëtarët e rinj të shtojnë gjuhë të tjera në sistemin institucional të Unionit. “Gjatë tri vjetëve të fundit jemi marrë me të gjitha çështjet, me të gjitha paqartësitë që janë shfaqur në lidhje me këtë. E kemi shpjeguar propozimin dhe mendoj se është krejtësisht e qartë se nuk ekziston absolutisht asnjë arsye që miratimi i këtij vendimi të vazhdojë të shtyhet”, tha Sampedro. “Thjesht, jemi të bindur se katalanishtja, galicishtja dhe baskishtja do të jenë gjuhë zyrtare të Bashkimit Evropian dhe shpresojmë që kjo të ndodhë së shpejti”, shtoi ai. Kërkesa spanjolle ishte një nga temat e takimit të sotëm të ministrave të BE-së përgjegjës për çështjet evropiane. Sipas burimeve diplomatike nga takimi i ministrave, ministri spanjoll e paraqiti qëndrimin e tij, megjithëse gjatë fjalimit, siç thanë burimet e REL-it, “nuk vendosi një lidhje eksplicite” mes pranimin të anëtarëve të rinj dhe vendimit për gjuhët. Spanja kërkoi që kjo çështje të futet në rendin e ditës për herë të parë pas më shumë se një viti. Megjithatë, diskutimi i sotëm nuk ishte paraparë si votim dhe nuk pritej ndonjë vendim përfundimtar për kërkesën. Këtë e konfirmoi edhe nikoqiri i takimit, ministri irlandez përgjegjës për çështjet evropiane, Tomas Birn, vendi i të cilit kryeson Këshillin e BE-së. “Do të kemi një diskutim të shkurtër, të cilin sot do ta nisë ministrja Sampedro lidhur me çështjen e gjuhëve. Nuk pres që sot të arrijmë ndonjë rezultat lidhur me këtë çështje. Do ta dëgjojmë se çfarë do të thotë kolegu ynë spanjoll dhe do ta shqyrtojmë atë. Këshilli më herët ka dhënë

një opinion ligjor lidhur me këtë çështje. Supozoj se, si përfaqësues i vendit që kryeson, do të duhet ta pranoj atë”, tha Birn. Opinioni ligjor i Shërbimit Juridik të Këshillit të BE-së për propozimin spanjoll të vitit 2023 u kërkuar pas diskutimit në takimin e Këshillit të BE-së për Çështjet e Përgjithshme, i cili u mbajt menjëherë pas dorëzimit të propozimit. Këshilli, megjithatë, atëherë nuk e publikoi opinionin e detajuar ligjor me shkrim. Në takimin joformal të ministrave në fillim të shtatorit, Spanja e riktheu dhe e intensifikoi çështjen e gjuhëve. Sekretari shtetëror për Çështjet Evropiane, Fernando Sampedro, në një parashtrësë drejtuar vendit që kryeson BE-në, e lidhi shprehimisht çështjen e gjuhëve me zgjerimin e ardhshëm. Ai tha se BE-ja së shpejti do të ketë më shumë gjuhë zyrtare dhe se Spanja shpreson që çështja e katalanishtes, galicishtes dhe baskishtes të zgjidhet para kësaj. Ky është një ndryshim i rëndësishëm pas disa muajsh ngecjeje në shqyrtimin e propozimit spanjoll. Herën e fundit që kjo çështje u diskutua në nivel ministrash ishte në korrik të vitit 2025. Atëherë kërkesa hasi në rezerva nga disa shtete anëtare, ndër të cilat ishte edhe Gjermania. Sipas burimeve të REL-it, Gjermania ishte shprehimisht kundër lidhjes së dy proceseve gjatë diskutimit mes ministrave. Ky qëndrim i Gjermanisë, sipas burimeve tona, u mbështet edhe nga të paktën dy shtete të tjera anëtare të BE-së. Sekretari shtetëror gjerman për Çështjet Evropiane, Gunther Krichbaum, tha para takimit se kundërshton, siç u shpreh ai, “bilateralizimin e procesit të



integritit në BE”. “Duhet të jemi të fortë së bashku. Dhe këtë unitet duhet ta vëmë në peshore. Para së gjithash, kjo na jep peshën që na nevojitet. Dhe çdo gjë që rrezikon mundësinë për të arritur marrëveshje me shtetet e tjera që dëshirojnë t’i bashkohen Bashkimit Evropian nuk është e dobishme”, tha Krichbaum për gazetarët. Ai u bëri thirrje kolegëve nga Madridi të tregojnë “pak më shumë frymë evropiane”. Gjermania është ndër shtetet anëtare që në fillim të shtatorit u dërguan institucioneve evropiane një propozim për kufizimin e përdorimit të vetos në disa fusha të vendimmarrjes së BE-së. Në propozim, ndër të tjera, thuhet se ekziston nevojja për të parandaluar përdorimin e vetos për realizimin e interesave të brendshme politike të shteteve anëtare. Nëse Spanja mbetet në qëndrimin se statusi i katalanishtes, baskishtes dhe galicishtes duhet të zgjidhet para zgjerimit të ardhshëm, kjo çështje mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta për dinamikën e anëtarësimit të Malit të Zi. Madridi, megjithatë, nuk ka deklaruar zyrtarisht se do ta bllokojë anëtarësimin e shteteve

të reja nëse kërkesa e tij nuk pranohet. Sampedro, duke iu përgjigjur pyetjes nëse kjo do të thotë se Spanja mund ta kushtëzojë pranimin e anëtarëve të rinj, përfshirë Malin e Zi, me zgjidhjen e çështjes së gjuhëve, e la këtë mundësi të hapur. Ai tha se është i bindur se çështja do të zgjidhet “shumë përpara” afatit të parë të zgjerimit të ardhshëm. Megjithatë, ai konfirmoi se Spanja e mbështet pranimin e Malit të Zi në BE. Mali i Zi është aktualisht shteti kandidat më i avancuar në procesin e anëtarësimit në BE. Deri më tani, ai ka mbyllur përkohësisht 18 nga 33 kapitujt e negociatave. Podgorica synon t’i përfundojë negociatat deri në fund të vitit 2026 dhe të bëhet anëtar i 28-të i BE-së në vitin 2028. Në Bruksel tashmë ka nisur edhe hartimi i projekt-marrëveshjes së anëtarësimit mes BE-së dhe Malit të Zi. Kjo përbën një hap të rëndësishëm në fazën përfundimtare të negociatave për anëtarësim. Kryesimi irlandez i Këshillit të BE-së ka bërë të ditur se përfundimi i negociatave me Malin e Zi do të jetë një nga prioritetet në fushën e zgjerimit.

QENDRA “GJENOCIDI NË KOSOVË - PLAGË E HAPUR” KËRKON
MEMORANDUM PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË
JASHTËZAKONSHME NË VEND

BARDHYL MAHMUTI: ZHBËRJA E DHOMAVE TË SPECIALIZUARA, DOMOSDOSHMËRI HISTORIKE PËR TË SHMANGUR RREZIKUN QË I KANOSËT KOSOVËS

Kryetari i Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur”, Bardhyl Mahmuti, ka kërkuar mobilizimin e të gjitha partive politike dhe veprim institucional pas aktgjykimit të 16 shtatorit të Dhomave të Specializuara në Hagë. Gjatë një konference për media të martën në Prishtinë, ai ka prezantuar një memorandum, përmes të cilit kërkon nga udhëheqësit e shtetit të Kosovës që të shpallin gjendje të jashtëzakonshme në vend, pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së. Mahmuti ka theksuar se dënimi ishte politik dhe ka kërkuar që institucionet dhe subjektet politike të reagojnë në mënyrë të koordinuar, me qëllim arritjen e një konsensusi për zhbërjen e Dhomave të Specializuara

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” ka mbajtur të martën konferencë të jashtëzakonshme për media, gjatë së cilës ka prezantuar një memorandum, përmes të cilit kërkon nga udhëheqësit e shtetit të Kosovës që të shpallin gjendje të jashtëzakonshme në vend, pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së, të cilët u dënuan me 81 vjet burgim. Kryetari i Qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur”, Bardhyl Mahmuti, ka thënë se vendimi i 16 shtatorit paraqet një situatë të jashtëzakonshme dhe cenon, siç u shpreh ai, kushtetutshmërinë dhe pavarësinë e Kosovës. “Qendra ‘Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur’ ka vendosur të mbajë konferencën e parë, sepse konsiderojmë se jemi para një gjendjeje të jashtëzakonshme”, tha ai, duke shtuar se vendimi i Dhomave të Specializuara, të cilat ai i përshkroi si institucione që “pretendojnë se janë të Kosovës”, sipas tij, “rrënon kushtetutshmërinë e Kosovës”. “Një vendim që rrënon kushtetutën e Kosovës, duke cenuar rëndë parimin kushtetutës, duke cenuar pavarësinë e Kosovës, duke hapur rrugë për të nxitur të gjithë ato qarqe luftë nxitëse në këtë pjesë të Ballkanit, mobilizimi i gjithanshëm është një domosdoshmëri e kohës.. Ne

kemi bërë një memorandum që në përputhje me kompetencat kushtetuese, që janë të përkufizuara se në çfarë rrethanash mund të shpallet gjendja e jashtëzakonshme, ne kërkojmë nga institucionet prej presidencës, qeverisë, partive politike e deputetëve të kuvendit, që të mobilizohen sepse çdo vonesë do të na kushtojë shumë”, ka thënë Mahmuti. Ai bëri thirrje për tejkalimin e dallimeve politike dhe për një mobilizim të përbashkët, duke e lidhur këtë me, siç tha, nevojën për mbrojtjen e shtetit të Kosovës përballë rreziqeve. “Dënimi ndaj udhëheqësve të UÇK-së ishte politik. Kërkojmë mobilizim nga të gjitha partitë politike dhe veprim institucional. Kjo gjykatë është politike dhe ka për qëllim për ta rrënuar shtetin tonë”, ka deklaruar Mahmuti. Ai ka deklaruar se zhbërja e Dhomave të Specializuara është domosdoshmëri historike për të shmangur rrezikun që i kanoset Kosovës. “Përballë kësaj gjendjeje të jashtëzakonshme, që rrezikon ardhmërinë e shtetit të pavarur të Kosovës, kërkohet të lihen anash të gjitha dallimet partiake, religjioze dhe krahinore, dhe të bashkuar t'i zhbëjmë Dhomat e Specializuara, që janë shndërruar në gjenerator të konflikteve të ardhshme në këtë pjesë të Ballkanit”, ka theksuar Mahmuti.



MEMORANDUM PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME

Znj. Albulena Haxhiu, Kryetare e Kuvendit të Kosovës dhe U.D. e Presidentit të Kosovës,
Z. Albin Kurti, Kryeministër i Qeverisë së Kosovës,
Deputetëve të Kuvendit të Kosovës,
Z. Bedri Hamza, kryetar i PDK-së,
Z. Lumir Abdixhiku, kryetar i LDK-së,
Z. Ardian Gjini, kryetar AK-së,
Z. Fatmir Limaj, kryetar i Nismës Socialdemokrate të Kosovës,
z. Dardan Mulliqi, kryetar i PSD-së,

Të nderuara Zonja,
Të nderuar Zotërinj,

Më 16 shtator 2026, Dhomat e Specializuara në Hagë shpallën aktgjykimin politik, që në emër të popullit të Kosovës, anashkaloi dispozitën themelore të Kushtetutës së saj: ligjshmërinë e përkufizimit të Republikës së Kosovës shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm.

Përmes këtij veprimi, ata krijuan një precedent, që paraqet rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë publike.

Për këtë arsye kërkojmë nga Kryetarja e Kuvendit të Kosovës dhe U.D. e Presidentit të Kosovës, zonja Albulena Haxhiu, që në konsultim me Kryeministrin e Kosovës, z. Albin Kurti, dhe në përputhje me nenin 131 të Kushtetutës së Kosovës TË SHPALLË GJENDJEN E JASHTËZAKONSHME.

Kërkojmë nga drejtuesit e partive politike dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, që të gjejnë konsensusin e domosdoshëm për zhbërjen e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

Arsyetimi

- Më 8 tetor 2008, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi rezolutën, përmes së cilës kërkoi që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të sqaronte “nëse shpallja e njëanshme e Pavarësisë së Kosovës nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës ishte në pajtim me të drejtën ndërkombëtare”.
Më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë shpalli konkluzionet: “Akti i miratimit të deklaratës së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, nuk ka shkelur as të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, as Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe as Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Prandaj miratimi i kësaj deklarate nuk ka shkelur asnjë rregull të aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare”.

Në vend që të respektohen konkluzionet e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në pikën 75 të përmbledhjes së asaj që u lexua gjatë shqiptimit të aktgjykimit, fillimisht Trupi Gjykses i përbërë nga Çarls L. Smith III, Kristof Barte, Ginel Metro dhe Fergal Gejnor; konstatoi se Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe persona të tjerë në udhëheqjen e UÇK-së, përfshirë anëtarët e tjerë të Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët, kishin dy objektiva: pavarësinë e Kosovës dhe vendosjen e kontrollit politik dhe institucional mbi atë që shpresonin se do të ishte një Kosovë e pavarur dhe se nuk e gjykuan të nevojshme të përcaktonin nëse këta dy objektiva ishin, në vetvete, kriminalë apo të paligjshëm.

- Përkundër faktit që neni 162 i Kushtetutës së shtetit të pavarur të Kosovës përkufizon në mënyrë të qartë, se Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë pjesë e sistemit të drejtësisë të Kosovës, Trupi Gjykses i përbërë nga Çarls L. Smith III, Kristof Barte, Ginel Metro dhe Fergal Gejnor morën vendim në kundërshtim të plotë me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
Vendimi për të mos “e gjykuan të nevojshme të përcaktonte, nëse objektivi për pavarësinë e Kosovës ishte, në vetvete, kriminal apo i paligjshëm” është përkufizim negativ, që jo vetëm nuk përfill vlerësimin e GJND-së për ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, por edhe ligjshmërinë së dispozitës themelore kushtetuese: përkufizimin e Republikës së Kosovës shtet i pavarur.
- Në procesin gjyqësor kundër Fatmir Limajt, Haradin Balajt, Isak Musliut dhe atë kundër Ramush Haradinajt, Lahi Ibrahimajt dhe Idriz Balajt, Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë hodhi poshtë si të pabaza përpjekjet për të shtrembëruar qëllimin e projektit për pavarësinë e Kosovës dhe prezantimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët.

Përkundër dy vendimeve në dy proceset e lartpërmendura gjyqësore, që përbëjnë jurisprudencën ndërkombëtare rreth kësaj çështjeje, Trupi Gjykses e cilësoi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët dhe, në pikën 80 të përmbledhjes së asaj që u lexua gjatë shqiptimit të aktgjykimit, theksohet se gjoja Ushtria Çlirimtare e Kosovës përdori mjete kriminale për realizimin e qëllimit për pavarësinë e Kosovës.

Duke pasur parasysh se në të kaluarën, Këshilli i Sigurimit i OKB-së i kishte dënuar shpalljet e pavarësisë të vendeve të caktuara, siç është rasti i Rodezisë Jugore, i Republikës Turke të Qipros Veriore dhe i Republikës Sërbske, për shkak të përdorimit të dhunës dhe shkeljeve të rënda të normave të së drejtës së përgjithshme humanitare ndërkombëtare, Trupi Gjykses i përbërë nga Çarls L. Smith III, Kristof Barte, Ginel Metro dhe Fergal Gejnor do të përpiqet t'i ekspozojë si fakte mijëra faqe të rasteve të fabrikuara nga Shërbimi Sekret i Serbisë, për të krijuar opinionin se pavarësia e Kosovës është realizuar përmes vrasjeve sistematike, arrestimeve, ndalimeve, trajtimeve çnjerëzore dhe formave të tjera të dhunës, që janë në kundërshtim të plotë me normat e së drejtës së përgjithshme humanitare ndërkombëtare.

- Përtej padrejtësive që u janë bërë katër njerëzve të pafajshëm, me dënime drakoniane mbi prova të sajura nga pala ndërluftuese që ka dashur ta mbajë Kosovën të pushtuar, vendimi i Trupit Gjykses i përbërë nga Çarls L. Smith III, Kristof Barte, Ginel Metro dhe Fergal Gejnor, i datës 16 shtator 2026, paraqet rrezik të drejtpërdrejtë ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë publike.
Ky vendim është në kundërshtim të plotë me Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me konkluzionet e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Për më tepër, duke shtrembëruar mjetet e përdorura për realizimin e qëllimeve politike të Luftës Çlirimtare të Kosovës, vendimi gjyqësor i 16 shtatorit 2026 u jep një armë të fuqishme forcave luftënxitëse që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

Përballë kësaj Gjendjeje të Jashtëzakonshme, që rrezikon ardhmërinë e shtetit të pavarur të Kosovës, kërkohet të lihen anash të gjitha dallimet partiake, religjioze dhe krahinore, dhe të bashkuar t'i zhbëjmë Dhomat e Specializuara, që janë shndërruar në gjenerator të konflikteve të ardhshme në këtë pjesë të Ballkanit.

Prishtinë, më 22.09.2026

Qendra “Gjenocidi në Kosovë – Plagë e hapur”
Bardhyl Mahmuti, Kryetar

Adnan Asllani Zëvendëskryetar



PETTIFER: PAS HAGËS, KOSOVA DUHET TA RISHIKOJË RAPORTIN ME MISIONET NDËRKOMBËTARE

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Kosova duhet ta rishikojë raportin me misionet ndërkombëtare pas aktgjykimit të Hagës, thotë historiani britanik, James Pettifer, duke vënë në pikëpyetje nëse misione si EULEX-i kanë ende rol në vend.

Në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, Pettifer, ligjërues i Historisë së Ballkanit në St Cross College, Universiteti i Oksfordit, thotë se Kosova nuk duhej ta refuzonte krijimin e Dhomave të Specializuara, por duhej të negocionte ndryshe kushtet mbi të cilat ato u themeluan. Ai argumenton se aktgjykimi ndaj Hashim Thaçit dhe tre ish-udhëheqësve të tjerë të UÇK-së mund ta vështirësojë edhe më tej pajtimin mes shqiptarëve dhe serbëve, ndërsa bën thirrje që reagimi ndaj tij të jetë politik dhe institucional.

Më 16 shtator, Dhomat e Specializuara dënuan Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin me nga 25 vjet burgim, Kadri Veselin me 18 dhe Rexhep Selimin me 13 vjet për krime lufte.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë bërë thirrje për respektimin e aktgjykimit.

Në Kosovë, të dielën u zhvilluan protesta kundër vendimit për të pestën natë me radhë, ndërsa,

të hënën, protestuan edhe studentët.

Partia Demokratike e Kosovës, e mbështetur edhe nga Aleanca, çoi në Kuvend nismën për ndryshimin e ligjit për Dhomat e Specializuara.

Profesor Pettifer, aktgjykimi në rastin Thaçi dhe të tjerët është tashmë është një fakt juridik, pavarësisht se si është pritur në Kosovë. Çfarë mund të bëjë Kosova në këtë pikë - politikisht dhe institucionalisht?

James Pettifer: Mendoj se ka mjaft mundësi. Natyrisht, aktgjykimi është aty dhe procesi i apelit do të nisë. Edhe pse nuk e dimë se çfarë forme do të marrë dhe as sa do të zgjasë, ai proces do të vazhdojë pavarësisht gjithçkaje. Por, mendoj se natyra e kësaj ngjarjeje është shumë serioze për Kosovën dhe se marrëdhëniet e zakonshme diplomatike dhe politike duhet të rishikohen.

A mund të shpjegoni më hollësisht se çfarë mendoni se duhet të bëhet?

James Pettifer: Është e qartë se marrëdhënia me NATO-n është thelbësore dhe ajo nuk duhet të përfshihet në këtë çështje. Dhe, mësa di unë, NATO-ja nuk ka qenë e përfshirë në asnjë

mënyrë në procesin e Dhomave të Specializuara. Por, situata me Evropën është krejt ndryshe. Siç ndoshta e keni parë edhe në X dhe në rrjete të tjera sociale, shumë njerëz me përgjegjësi mendojnë se organizata si EULEX-i, OSBE-ja dhe të tjera duhet të mbyllen. Ato i përkasin së kaluarës. Personalisht, mendoj se ky është drejtimi i duhur, veçanërisht sa i përket misionit të EULEX-it.

A mendoni se ky është një opsion i mundshëm?

James Pettifer: Po. Kosova është shtet sovran dhe i njohur. Dua të them se - mësa e kuptoj unë - këta njerëz janë në Kosovë vetëm me pëlqimin e Qeverisë. NATO-ja është në një pozitë tjetër, por, siç e thashë, NATO-ja nuk ka qenë e përfshirë në procesin [e Dhomave të Specializuara]. Por, veçanërisht sa i përket EULEX-it, nuk shoh arsye përse duhet të vazhdojë, kur qartazi është një mjet për interesat e Serbisë.

Ju keni thënë se Kosova ishte naive që bashkëpunoi me Dhomat e Specializuara. Çfarë duhej të kishte bërë ndryshe?

James Pettifer: Mendoj se këtë e ka vënë në dukje edhe Dr. Daniel Serwer në Uashington, i cili, prej kohësh, është njohës i

rajonit dhe i Kosovës. Ai ka bërë një analizë shumë të mirë të mënyrës se si u përcaktuan kushtet fillestare të funksionimit të Dhomave të Specializuara - në një formë që nuk parashihte asnjë kontroll nga Qeveria [e Kosovës]. Kështu, në praktikë, Dhomat e Specializuara mund të manipuloheshin nga interesa të jashtme.

Por, a mendoni se kishte ndonjë alternativë reale për një vend aq të varur nga mbështetja perëndimore? A mund të kishte thënë Kosova “jo”?

James Pettifer: Nuk ishte e nevojshme të thoshte “jo”. Duhej të negocionte në mënyrë profesionale se cilat do të ishin kushtet. Unë isha në favor të përfshirjes së një tribunali për krimet e luftës, sepse të gjitha vendet e tjera të rajonit e kishin një të tillë dhe nuk do të ishte e përshtatshme që Kosova të mos e kishte. Por, kjo u bë në një mënyrë që nënkuptonte se Kosova nuk kishte kontroll mbi procesin, dhe ky problem daton që nga fillimi. Unë ua kam vënë në dukje këtë edhe diplomatëve të Kosovës në Londër, por ata nuk kanë menduar njësoj. Nuk besoj se e kuptonin vërtet se cili mund të ishte problemi.

Pra, shikuar nga kjo perspektivë,

a e keqkuptoi Kosova atë për të cilën po pajtohej kur e themeloi Gjykatën... apo thjesht nuk kishte zgjidhje?

James Pettifer: Jo, nuk mendoj se çështja ishte nëse Kosova duhej ta refuzonte Gjykatën. Nuk ishte ky problemi. Çështja ishte nëse ajo ishte krijuar mbi baza të drejta dhe profesionale.

Ju keni thënë, gjithashtu, se ky aktgjykim mund ta kthejë shumë prapa procesin e pajtimit mes serbëve dhe shqiptarëve. A mund të bëjë diçka Kosova tani për ta parandaluar këtë?

James Pettifer: Jo, nuk mendoj se mundet. Verdicti tashmë është marrë dhe, siç besoj se e keni parë, në Kosovë ka protesta të mëdha kundër tij. Kjo do ta bëjë shumë të vështirë - ndoshta edhe të pamundur - arritjen e çfarëdo kompromisi me Serbinë për çështje të caktuara.

Por, procesi i pajtimit po haste në vështirësi të mëdha edhe para këtij aktgjykimi. Pse mendoni se ky vendim do ta përkeqësojë edhe më shumë situatën?

James Pettifer: Sepse ekziston përshtypja se bashkësia ndërkombëtare nuk është neutrale. Kjo është një gjykatë ndërkombëtare dhe, sidomos për shkak të gjatësisë së

NIS BETEJA NË APEL PËR KATËR ISH-KRERËT E UÇK-së

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Pas dënimit në shkallën e parë, ka nisur zyrtarisht beteja ligjore në Apel për katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi, të cilët javën e kaluar u dënuan me gjithsej 81 vjet burgim për krime lufte.

Ekipet e mbrojtjes kanë nisur këtë javë procedurat për njoftimin e Dhomat të Specializuara të Kosovës për apelimin e vendimit.

Mbrojtja ka afat deri të premten, më 25 shtator, për të njoftuar gjykatën se cilat pjesë të verdiktit do të kundërshtohen.

Thaçi dhe Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, Veseli me 18 vjet, ndërsa Selimi me 13 vjet burgim.

Mbrojtja ka bërë me dije se verdikti përmban disa pika që do të kundërshtohen në Apel, veçanërisht ato që lidhen me

përgjegjësinë për vrasjet dhe ndalimet e paligjshme, në rrethana kur ndërhyr një palë e tretë, në këtë rast NATO.

Ndërkohë, avokati i viktimave ka afat deri më 14 tetor për të paraqitur prova lidhur me dëmshpërblimet, ndërsa Prokuroria ka afat deri më 4 nëntor për të dorëzuar shkresat e saj.

Amer Alija nga Fondi për të Drejtën Humanitare, i cili monitoron gjykimet për krime lufte, ka thënë për Radio Kosovën se procesi i apelit përfshinë disa etapa dhe pritet të zgjasë disa muaj, nga dorëzimi i njoftimit për ankimim deri te vendimi përfundimtar.

Sipas tij, rregullorja e procedurës dhe provave parasheh disa afate për njoftimet, përgjigjet ndaj ankesave, paraqitjen e ankesave dhe caktimin e seancës në gjykatën e shkallës së dytë.

Ndërkohë, në Kosovë, Partia



Demokratike e Kosovës ka dorëzuar në Kuvend një projekt-nismë për ndryshimin e

Ligjit për Dhomat e Specializuara, duke thënë se synon më shumë llogaridhënie

dhe transparencë të kësaj gjykate, e cila është e zhvendosur në Holandë.

MË 1 TETOR ORGANIZOHET MARSHI “JO NË EMRIN TIM”

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Platforma qytetare “Liria ka emër” ka kërkuar angazhim dhe koordinim të institucioneve të Kosovës, pas shpalljes së aktgjykimit dënues për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin nga Gjykata Speciale në Hagë, më 16 shtator.

Ndërsa, kanë theksuar se më 1 tetor nga ora 16:00, në sheshin “Skënderbeu” do të organizojnë marsh paqësor me moton “Jo në emrin tim”.

Përfaqësuesi i kësaj platforme, Ismail Tasholli, u ka bërë thirrje spektrit politik, diplomatëve, shoqërisë civile, ekspertëve dhe mërgatës të bëhen pjesë e një përpjekjeje të koordinuar lidhur me këtë proces. “Sot nuk jemi këtu për pushtet e opozitë. Nuk



jemi këtu për të hapur betejat e djeshme politike. Sot duhet të jemi bashkë. Përpara nesh është një proces vendimtar dhe një fazë e re juridike. Prandaj kërkojmë që institucionet e

Republikës së Kosovës të veprojnë me përgjegjësi, koordinim dhe transparencë. Qeveria duhet të na tregojë qartë: Cili është plani? Cila është strategjia shtetërore? Çfarë

mbështetjeje juridike dhe financiare do të ofrohet? Çfarë do të bëjë diplomacia e Kosovës? Si do të angazhohen institucionet akademike dhe ekspertët ndërkombëtarë?”, tha ai.

Tasholli bëri thirrje që sa më parë të ftohet një mbledhje e përbashkët e Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Shqipërisë. “Me një pikë të rendit të ditës, mbështetjen institucionale për mbrojtjen e luftës së UÇK-së dhe sigurimin e financimit të nevojshëm për mbrojtjen juridike. Sepse, në këto momente nuk duhet të ketë Prishtinë e Tiranë që shikojnë larg njëra-tjetrën. Duhet të ketë një tavolinë, një koordinim dhe një përgjegjësi të përbashkët institucionale”,

kërkoi Tasholli.

Ndërsa, përfaqësuesja tjetër e LKE-së, Eliza Hoxha, ka theksuar se platforma qytetare “Liria ka emër”, në vazhdimësi do të zhvillojë aktivitete qytetare, akademike dhe publike në Kosovë dhe jashtë saj. “Qeverisë i kërkojmë plan. Institucioneve u kërkojmë koordinim. Partive politike u kërkojmë bashkëpunim. Mërgatës dhe qytetarëve u bëjmë thirrje për pjesëmarrje qytetare. Sot nuk kërkojmë që të gjithë të mendojnë njësoj. Kërkojmë që institucionet të marrin përgjegjësi të tyre dhe që dallimet politike të mos e pengojnë koordinimin për çështjet që konsiderohen me interes shtetëror”, theksoi Hoxha.

dënimeve dhe cilësisë shumë të dobët juridike të disa pjesëve të aktgjykimit, njerëzit nuk do ta respektojnë atë. Dhe kjo, mendoj, do të ndikojë shumë edhe në proceset normale diplomatike.

Ju keni shkruar gjerësisht për origjinën dhe zhvillimin e UÇK-së. A ndryshon ky aktgjykim diçka në mënyrën se si do ta shkruanit sot historinë e saj?

James Pettifer: Ky aktgjykim është pjesë e historisë. Por, nuk mendoj se mund t'i përgjigjem kësaj pyetjeje derisa të publikohet teksti i plotë i procesit gjyqësor, dhe në veçanti ajo që ka ndodhur në seancat e mbyllura. Gjykata, gjithashtu, duhet t'i bëjë të ditura burimet mbi të cilat i ka mbështetur pretendimet

e saj, të cilat, në shumë raste, mësa kam mundur të shoh gjatë procesit gjyqësor, nuk janë dhënë.

Por, sa peshë duhet të ketë ky aktgjykim në mënyrën se si kuptohet dhe kujtohet lufta në Kosovë?

James Pettifer: Nuk mendoj se duhet të ketë fare peshë, veçanërisht sepse nuk ka të bëjë me vetë luftën. Natyrisht, ky është një sulm ndaj UÇK-së - gjë që serbët dhe rusët e kanë dashur gjithmonë. Fillimisht u përpoqën përmes akuzave të pabaza të Dick Martyt. Për fat të mirë, ato akuza nuk çuan askund në sistemin gjyqësor. Por, më pas u gjetën akuza të tjera, të cilave mund t'u jepej më shumë peshë.

Njëzet e shtatë vjet pas luftës, a ka bërë Kosova mjaftueshëm për ta dokumentuar historinë e vet?

James Pettifer: Mendoj se ka bërë një punë mjaft të mirë. Është botuar shumëçka që prej kohës kur e shkrova librin tim, i cili u botua gati 20 vjet më parë. Mendoj se ai u botua si një lloj historie e përgjithshme e UÇK-së. Sot dihet shumë më tepër për çështje të caktuara, por nuk mendoj se ajo që kam parë, e ndryshon argumentin themelor: se, në rrethanat e asaj kohe, një lëvizje e armatosur e rezistencës ishte e pashmangshme dhe ishte pjesë e asaj që prodhoi kriza në Jugosllavi.

Dhe, për fund, sikur ta kështillonit Kosovën sot, cilat janë dy ose tri gjërat që duhet t'i bëjë dhe cilat

janë ato që duhet t'i shmangë?

James Pettifer: Mendoj se duhet shmangur dhuna, sepse dhuna në rrugë do t'i dobësonte shumë argumentet morale kundër këtij procesi gjyqësor, që unë e konsideroj të padrejtë. Por, natyrisht, protestat janë të rëndësishme dhe shpresoj të jenë të mëdha. Megjithatë, mendoj se çështja kryesore është se çfarë do të bëjë Qeveria e Kosovës. Reagimi i [kryeministrit], zotit [Albin] Kurti, më duket disi i dobët. Do të shohim se çfarë do të bëjë konkretisht. Është ende herët, por Qeveria duhet ta trajtojë çështjen e legjitimitetit të organizatave si EULEX-i dhe nëse ato vazhdojnë të jenë të nevojshme në Kosovë. Mendoj se shumica dërrmuese e

njerëzve, ndoshta edhe disa serbë të Kosovës, do të donin t'i shihnin këto misione të përfundonin. Kjo, mendoj unë, është çështja kryesore me të cilën duhet të përballlet zoti Kurti. Nëse OSBE-ja ka ende ndonjë rol të dobishëm, nuk e di. Nga sa di unë, duket se është një organizatë shumë e kushtueshme, e cila në shumicën e rasteve mbledh të dhëna që tashmë i dimë shumë mirë. Pra, të gjitha këto çështje mund të rishikohen. Por, për këtë do të nevojitet një qëndrim i qartë dhe i bashkuar. Siç kam shkruar edhe në X, është e rëndësishme që elita e Kosovës të punojë së bashku dhe të zhvillojë politika të forta dhe të përbashkëta ndaj këtyre organizatave.

REAGIM SHTETËROR NDAJ AKTGJYKIMIT TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS



Shkruan: Akademik Arsim Bajrami

Aktgjykimi i Dhomave të Specializuara të Kosovës në çështjen kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit përbën një zhvillim me rëndësi të veçantë për rendin juridik, jetën institucionale dhe kujtesën historike të Republikës së Kosovës. Aktgjykimi i 16 shtatorit 2026 i shpalli të akuzuarit fajtorë për katër vepra penale të krimeve të luftës dhe shqiptoi dënime individuale ndaj tyre. Duke qenë aktgjykim i shkallës së parë, ai i nënshtrohet mjeteve juridike të parashikuara nga kuadri juridik i Dhomave të Specializuara dhe, për rrjedhojë, çështja mbetet objekt i shqyrtimit të mëtejshëm gjyqësor. Përtej pasojave juridike për personat e gjykuar, ky zhvillim kërkon një përgjigje të organizuar dhe profesionale në të gjitha instancat juridike në të cilat mund të shqyrtohet çështja. E drejta e mbrojtjes për të kundërshtuar aktgjykimin dhe për të kërkuar rishikimin e gjetjeve të tij përmes mjeteve juridike në dispozicion duhet të mbështetet me ekspertizën më të avancuar juridike ndërkombëtare. Në këtë drejtim, duhet të angazhohen ekspertë, kompani dhe ekipe të specializuara me përvojë të dëshmuar në të drejtën penale ndërkombëtare nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet kryesore evropiane, për të asistuar ekipet e mbrojtjes në analizën e aktgjykimit, në identifikimin e çështjeve të së drejtës dhe të provave dhe në përgatitjen e argumenteve të plota për procedurat e mëtejshme juridike. Ky angazhim duhet të përfshijë veçanërisht analizën e bazës juridike të përgjegjësisë individuale, standardit të provës, vlerësimit të provave, lidhjes ndërmjet përgjegjësisë individuale dhe përgjegjësisë së pretenduar kolektive, si dhe çështjes së ndërmarrjes së përbashkët

kriminale (Joint Criminal Enterprise - JCE), aty ku kjo doktrinë është përdorur ose ka ndikuar në përcaktimin e përgjegjësisë. Qëllimi i këtij angazhimi nuk është ndërhyrja në pavarësinë e gjykatës, por siguri i një mbrojtjeje juridike sa më profesionale dhe i një shqyrtimi sa më rigoroz të çështjeve të së drejtës dhe të provave. Në mënyrë të veçantë, duhet të zhvillohet një analizë e thelluar e qëndrueshmërisë juridike të konceptit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe të mënyrës së aplikimit të tij në këtë çështje. Në këtë kuadër, qëndrueshmëria juridike e konstruktit të NPK-së duhet të vlerësohet në mënyrë të veçantë në procedurat e ankimit. Analiza duhet të përqendrohet në përputhshmërinë e konstatimeve faktike me elementet juridike të përgjegjësisë, në standardin e provës përtej dyshimit të arsyeshëm. Për këtë arsye, çdo element i NPK-së duhet t'i nënshtrohet një kontrolli të veçantë juridik, faktik dhe provues, pa paragjykuar rezultatin e procedurave të mëtejshme. Në veçanti, ekipet ndërkombëtare të angazhuara duhet të asistojnë mbrojtjen në argumentimin juridik për rrëzimin e gjetjeve që mbështesin ekzistencën e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, nëse dhe në masën që këto gjetje përbëjnë bazë të përgjegjësisë së të akuzuarve. Çështje të tilla kërkojnë analizë të thellë të standardeve të përgjegjësisë penale, të elementeve juridike të JCE-së, të zbatueshmërisë së saj në kohën e ngjarjeve dhe të mënyrës së aplikimit të saj ndaj përgjegjësisë individuale. Kjo qasje duhet të shoqërohet me një mobilizim të gjerë të ekspertizës akademike shqiptare dhe ndërkombëtare. ASHAK-u, universitetet dhe institutet

kërkimore duhet të kontribuojnë, në përputhje me kompetencat dhe autonominë e tyre akademike, në studimin e burimeve historike, juridike dhe dokumentare që lidhen me luftën e Kosovës, duke krijuar një bazë të fuqishme shkencore për kuptimin e kontekstit historik në të cilin kanë ndodhur ngjarjet. Drejtësia penale ndërkombëtare ka për objekt përcaktimin e përgjegjësisë individuale mbi bazën e provave, fakteve dhe standardeve të përcaktuara juridike. Për këtë arsye, përgjegjësia penale duhet të mbetet e individualizuar dhe nuk mund të shndërrohet në përgjegjësi kolektive, politike apo historike. Në të njëjtën kohë, një aktgjykim penal, sado i rëndësishëm të jetë, nuk mund të zëvendësojë kërkimin shkencor dhe dokumentimin e gjithanshëm të historisë së një konflikti, të një shoqërie dhe të një procesi të tërë shtetndërtimit. Në këtë kontekst, ekziston një shqetësim serioz se interpretimet e caktuara të kontekstit historik të luftës, nëse shpëputen nga tërësia e fakteve dhe zhvillimeve që e karakterizuan Kosovën, mund të prodhojnë një narrativë të reduktuar të historisë së saj dhe të krijojnë premisa për rishikimin e njëanshëm të periudhës së luftës dhe të procesit të shtetndërtimit. Një rrezik i tillë duhet trajtuar si çështje e interesit të përgjithshëm shtetëror dhe historik. Historia e Kosovës dhe lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duhet të studiohen në tërësinë e tyre: në raport me represionin sistematik, gjenocidin e Serbisë ndaj popullsisë shqiptare, luftën çlirimtare, shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, ndërhyrjen ndërkombëtare, administrimin ndërkombëtar dhe procesin juridik e politik që çoi në krijimin dhe konsolidimin e institucioneve të Republikës së Kosovës. Asnjë

dimension i kësaj historie nuk mund të shpëputet artificialisht nga tërësia e saj.

Paqëndrueshmëria e mundshme juridike e disa prej konstruksioneve mbi të cilat është mbështetur përgjegjësia penale në këtë çështje duhet të trajtohet ekskluzivisht përmes mjeteve juridike dhe argumentimit profesional. Në veçanti, duhet të vlerësohet nëse arsyetimi gjyqësor ka bërë një shtrembim të karakterit të përgjithshëm të strukturave politike, ushtarake të UÇK-së. Çdo zgjerim i përgjegjësisë përtej veprimeve konkrete duhet t'i nënshtrohet kontrollit të rreptë në dritën e parimit të ligjëshmërisë dhe standardit të provës në të drejtën penale ndërkombëtare. Pikërisht për këtë arsye, procedura e ankimit duhet të shërbejë si mekanizëm i plotë për verifikimin e bazës juridike, arsyetimit, vlerësimit të provave dhe individualizimit të përgjegjësisë. Për këtë arsye, përgjigja ndaj këtij zhvillimi duhet të jetë mbi të gjitha institucionale, akademike, juridike dhe shtetërore. Republika e Kosovës duhet të ndërtojë kapacitete të qëndrueshme për dokumentimin e historisë së saj, mbrojtjen e rendit të saj kushtetues dhe paraqitjen profesionale të fakteve historike e juridike në hapësirën vendore dhe ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, kërkohen këto dhjetë masa shtetërore dhe institucionale:

- Tejkalimi i bllokadës kushtetuese dhe funksionalizimi i plotë i institucioneve.** Prioritet i menjëhershëm duhet të jetë tejkalimi i çdo bllokade kushtetuese dhe institucionale dhe siguri i funksionimit të plotë të Kuvendit, Qeverisë dhe institucioneve të tjera kushtetuese. Vetëm institucionet

funksionale dhe legjitime mund të ndërtojnë një përgjigje të qëndrueshme shtetërore ndaj zhvillimeve juridike që prekin drejtpërdrejt kujtesën historike, interpretimin e luftës së Kosovës dhe procesin e shtetndërtimit. Funksionalizimi institucional duhet të krijojë kapacitetin për të dokumentuar në mënyrë sistematike rrethanat politike, juridike dhe shoqërore në të cilat u zhvillua lufta e Kosovës dhe veprimtaria e UÇK-së, duke siguruar që interpretimi i këtyre zhvillimeve të mos mbetet vetëm në burime të pjesshme ose në narrativë të njëanshme. Njëkohësisht, funksionimi i institucioneve është parakusht për ndarjen e qartë ndërmjet përgjegjësisë penale individuale dhe vlerësimit historik të një periudhe të tërë.

- Ndërtimi i një konsensusi ndërpartiak për çështjet themelore shtetërore.** Pozita dhe opozita duhet të ndërtojnë një konsensus institucional për çështjet që tejkalojnë konkurrencën politike dhe lidhen me interesat themelore të Republikës së Kosovës. Ky konsensus duhet të përfshijë dokumentimin e luftës, ruajtjen e trashëgimisë dokumentare të UÇK-së, mbështetjen e hulumtimit shkencor dhe paraqitjen e fakteve historike në hapësirën ndërkombëtare. Qasja konsensuale është e rëndësishme për të shmangur që historia e luftës dhe procesi i shtetndërtimit të trajtohen si çështje të përkohshme të një partie ose qeverie. Ajo duhet të sigurojë një qëndrim institucional të qëndrueshëm se çdo përgjegjësi penale vlerësohet individualisht nga organet gjyqësore, ndërsa historia e luftës duhet të dokumentohet dhe studiohet në tërësinë e saj.

3. Miratimi i një rezolute të Kuvendit për qëndrimin institucional të Republikës së Kosovës.

Kuvendi duhet të zhvillojë një debat të posaçëm dhe të përcaktojë, përmes një akti institucional, parimet themelore të veprimit shtetëror pas aktgjykimit. Rezoluta duhet të afirmojë nevojën për respektimin e procedurave gjyqësore dhe të mjeteve juridike, por njëkohësisht të përcaktojë përgjegjësinë e institucioneve për dokumentimin e plotë të luftës së Kosovës dhe të rrethanave historike në të cilat veproi UÇK-ja. Ajo duhet të bëjë të qartë se një aktgjykim penal, pavarësisht përfundimit të procedurave gjyqësore, nuk përbën në vetvete një histori gjithëpërfshirëse të luftës së Kosovës dhe nuk mund të zëvendësojë hulumtimin historik, arkivor dhe akademik. Në këtë mënyrë, Kuvendi do të vendoste një dallim institucional ndërmjet drejtësisë penale dhe kujtesës historike.

4. Hartimi i një Plani Shtetëror për Veprim.

Qeveria, në bashkëpunim me Kuvendin dhe institucionet kompetente, duhet të hartojë një Plan Shtetëror për Veprim, me objektiva, afate, institucione përgjegjëse dhe burime financiare. Plani duhet të mbështetet në një model të integruar, të frymëzuar nga përvoja krahasuese, i cili lidh veprimin juridik, dokumentimin historik, mbrojtjen sociale të kategorive të dala nga lufta, kujtesën institucionale, memorializimin, kërkimin shkencor dhe diplomacinë dokumentuese. Në mënyrë të veçantë, Plani duhet të përmbajë një komponent të posaçëm për dokumentimin e rolit, organizimit, veprimtarisë dhe kontekstit historik të UÇK-së, mbi bazën e burimeve arkivore, dëshmive, dokumenteve vendore dhe ndërkombëtare dhe metodologjive të pranura shkencore. Qëllimi nuk duhet të jetë krijimi i një narrative propagandistike, por siguri që historia të mos reduktohet në vetëm një proces penal ose në një interpretim të vetëm gjyqësor. Dokumentimi i plotë është instrumenti kryesor për të parandaluar deformimin, selektimin ose rishikimin e njëanshëm të historisë.

5. Angazhimi i ekspertizës juridike ndërkombëtare për mbrojtjen.

Duhet të krijohet një mekanizëm shtetëror për mbështetjen, në përputhje me ligjin dhe pa cenuar pavarësinë e mbrojtjes, të ekipeve të mbrojtjes me ekspertë dhe firma prestigjioze amerikane dhe evropiane të së drejtës penale ndërkombëtare, me qëllim asistimin në përgatitjen e mjeteve juridike kundër aktgjykimit, veçanërisht në çështjet e përgjegjësisë individuale, standardit të provës, vlerësimit të provave dhe bazës juridike të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Ky mekanizëm duhet të ketë karakter të përhershëm dhe të përfshijë një njësi për analizën e jurisprudencës ndërkombëtare, një njësi për dokumentimin dhe sistematizimin e provave dhe një njësi për koordinimin me ekipet e

mbrojtjes. Një nga objektivat kryesore duhet të jetë siguri që çdo gjetje juridike që lidhet me UÇK-në, strukturat e saj dhe individët e akuzuar të shqyrtohet mbi bazën e përgjegjësisë së individualizuar dhe standardeve të përgjegjësisë penale. Në këtë mënyrë, mbrojtja juridike e individëve nuk do të ngatërrohet me një vlerësim të përgjithshëm historik të UÇK-së ose të luftës së Kosovës.

6. Themelimi i një institucioni shtetëror për dokumentimin e luftës dhe shtetndërtimit.

Republika e Kosovës duhet të ndërmarrë procedurat ligjore për themelimin e një institucioni të specializuar për dokumentimin e luftës dhe procesit të shtetndërtimit, në bashkëpunim të ngushtë me ASHAK-un, universitetet, institutet dhe arkivat. Ky institucion duhet të ndërtohet sipas një modeli të qëndrueshëm shtetëror, të frymëzuar nga përvoja e Republikës së Kroacisë, por i përshtatur plotësisht me rrethanat kushtetuese, historike dhe shoqërore të Kosovës. Institucioni duhet të ketë mandat të posaçëm për mbledhjen, ruajtjen, digjitalizimin, katalogimin dhe publikimin e dokumenteve që lidhen me luftën e Kosovës, përfshirë dokumentet mbi veprimtarinë e UÇK-së, zhvillimet politike dhe ushtarake, marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtare, dëshmitë e popullsisë civile, viktimat, personat e zhdukur, ndërhyrjen ndërkombëtare dhe procesin që çoi në përfundimin e luftës dhe në ndërtimin institucional të Kosovës. Modeli kroat është i rëndësishëm pikërisht për karakterin e tij të integruar institucional. Për Kosovën, rëndësia e këtij modeli qëndron në krijimin e një sistemi të përhershëm ku dokumentimi i luftës, kujtesa institucionale dhe kërkimi shkencor nuk varen nga ciklet politike. Një institucion i tillë do të krijonte bazën dokumentare të nevojshme për të kundërshtuar çdo përpjekje për shpëputjen e ngjarjeve nga konteksti i tyre historik ose për reduktimin e historisë së Kosovës në interpretimin e një procesi të vetëm gjyqësor.

7. Program Shtetëror për hulumtimin shkencor të luftës dhe shtetndërtimit.

Duhet të ndërtohet një program afatgjatë shtetëror për kërkimin shkencor, botimin e dokumenteve arkivore, monografive dhe studimeve akademike. ASHAK-u duhet të ketë rol qendror akademik dhe koordinues, ndërsa universitetet dhe institutet duhet të zhvillojnë projekte kërkimore, konferenca, botime dhe studime ndërdisiplinare. Programi duhet të përfshijë financim të rregullt publik për projekte kërkimore, bursa për studiues të rinj, përkthimin e dokumenteve në gjuhë të huaja, krijimin e bazave të të dhënave dhe bashkëpunimin me institucione akademike ndërkombëtare. Një pjesë e veçantë e tij duhet t'i kushtohet studimit shkencor të luftës së Kosovës, përfshirë shkaqet dhe rrethanat e konfliktit, represionin dhe shkeljet e të drejtave të njeriut,



strukturat dhe veprimtarinë e UÇK-së, marrëdhëniet ndërmjet faktorëve politikë dhe ushtarakë, ndërhyrjen ndërkombëtare dhe procesin e shtetndërtimit. Qëllimi i këtij programi duhet të jetë krijimi i një baze të verifikueshme shkencore që mundëson një kuptim të plotë të historisë së luftës dhe parandalon që boshllëqet dokumentare të plotësohen nga narrativa selektive. Kërkimi shkencor nuk duhet të shërbejë për të zëvendësuar drejtësinë penale, por për të garantuar që historia e luftës të trajtohet si objekt i pavarur i hulumtimit historik, juridik dhe shoqëror.

8. Forcimi i diplomacisë juridike dhe dokumentuese të Republikës së Kosovës.

Institucionet kompetente, në bashkëpunim me ASHAK-un, universitetet dhe institutet kërkimore, duhet të ndërtojnë kapacitete të qëndrueshme për prezantimin profesional të dokumentacionit juridik dhe historik të Kosovës në hapësirën ndërkombëtare. Në këtë kuadër, duhet të krijohet një qendër e posaçme për diplomaci dokumentuese dhe komunikim strategjik, e cila do të përgatisë dosje faktike, raporte periodike, botime shumëgjuhëshe, materiale për institucionet ndërkombëtare dhe programe informuese për opinionin publik ndërkombëtar. Në këto materiale duhet të paraqiten, në mënyrë të dokumentuar dhe metodologjiskisht të verifikueshme, faktet mbi rrethanat e luftës, represionin ndaj popullsisë civile, zhvillimet politike dhe ushtarake, veprimtarinë e UÇK-së, ndërhyrjen ndërkombëtare dhe procesin e shtetndërtimit. Diplomacia dokumentuese duhet të synojë që historia e Kosovës të jetë e pranishme në literaturën akademike, institucionet ndërkombëtare dhe debatet profesionale mbi bazën e dokumenteve dhe burimeve të verifikueshme. Në këtë mënyrë, Republika e Kosovës do të krijonte kapacitetin institucional për t'iu përgjigjur deformimeve ose interpretimeve të njëanshme të historisë, pa cenuar pavarësinë e institucioneve gjyqësore dhe pa zëvendësuar debatit akademik me komunikim politik.

9. Forcimi i kuadrit ligjor për kategoritë e dala nga lufta dhe kujtesën institucionale.

Duhet të rishikohet dhe, kur është e nevojshme, të forcohet kuadri ligjor për kategoritë e dala nga lufta dhe ruajtjen institucionale të kujtesës së luftës, duke studiuar në mënyrë sistematike përvojën krahasuese të Republikës së Kroacisë. Modeli kroat duhet të shërbejë si pikë referimi për ndërtimin e një sistemi të plotë, por jo për kopjim mekanik. Për Kosovën, ky sistem duhet të përfshijë mbrojtjen juridike dhe sociale të kategorive të dala nga lufta, dokumentimin e dëshmive të tyre, ruajtjen e kujtesës institucionale dhe krijimin e mekanizmave për memorializimin e ngjarjeve dhe personave që lidhen me luftën. Në këtë kuadër, duhet të shqyrtohet hartimi i një Ligji gjithëpërfshirës për Luftën Çlirimtare dhe Kujtesën Shtetërore, i cili do të përcaktonte parimet e dokumentimit, mbrojtjes sociale, memorializimit, edukimit publik dhe përfaqësimit ndërkombëtar të historisë së luftës së Kosovës. Ky ligj duhet të sigurojë që dokumentet dhe dëshmitë që lidhen me luftën dhe me veprimtarinë e UÇK-së të ruhen si pjesë e trashëgimisë dokumentare të Republikës së Kosovës. Një komponent i veçantë duhet t'u kushtohet personave të zhdukur, viktimave civile, familjeve të tyre dhe kategorive të tjera të prekura nga lufta. Dokumentimi i plotë i përvojave të tyre është i domosdoshëm për një histori gjithëpërfshirëse të luftës dhe për të shmangur selektimin e kujtesës sipas interesave të momentit. Duhet të krijohet gjithashtu një Regjistër Shtetëror i kategorive të dala nga lufta dhe viktimave, i administruar me standarde të larta të mbrojtjes së të dhënave, si dhe një sistem transparent verifikimi. Paralelisht, duhet të zhvillohet një rrjet i qendrave shtetërore për veteranët dhe kategoritë e dala nga lufta, ku kujtesa, dokumentimi, shërbimet sociale, rehabilitimi dhe edukimi historik të trajtohen në mënyrë të integruar.

10. Krijimi i një Këshilli Ndërinstitucional për luftën dhe shtetndërtimin e Kosovës.

Duhet të themelohet një Këshill Ndërinstitucional me përfaqësim

të institucioneve kompetente, ASHAK-ut, universiteteve, instituteve kërkimore, institucioneve arkivore dhe ekspertëve të pavarur. Këshilli duhet të ketë mandat të qartë për koordinimin e politikave shtetërore, mbikëqyrjen e zbatimit të Planit Shtetëror për Veprim, harmonizimin e dokumentimit, kërkimit shkencor, diplomacisë dokumentuese dhe politikave sociale për kategoritë e dala nga lufta. Një funksion i rëndësishëm i tij duhet të jetë koordinimi i përpjekjeve për ruajtjen dhe paraqitjen e dokumentuar të historisë së luftës së Kosovës dhe të rolit të UÇK-së, në mënyrë që dokumentacioni të jetë i plotë, i qasshëm dhe i mbështetur në standarde akademike. Këshilli duhet të raportojë rregullisht para Kuvendit dhe publikut dhe të sigurojë që përgjegjësitë të mos shpërmdahen ndërmjet institucioneve pa koordinim dhe pa rezultate konkrete. Nëpërmjet këtij mekanizmi duhet të sigurohet vazhdimësia e politikës shtetërore të dokumentimit dhe kujtesës, pavarësisht ndryshimeve të qeverive dhe cikleve politike. Në tërësi, këto dhjetë masa duhet të funksionojnë si pjesë të një politike të integruar shtetërore për mbrojtjen juridike, dokumentimin historik dhe ruajtjen e kujtesës së luftës së Kosovës. Mbrojtja e luftës së UÇK-së në këtë kuadër duhet të kuptohet si mbrojtje e bazuar në dokumente, burime, dëshmi dhe hulumtim shkencor të kontekstit në të cilin ajo u zhvillua, ndërsa çdo çështje e përgjegjësisë penale duhet të mbetet e individualizuar dhe t'i nënshtrohet standardeve të drejtësisë penale. Qëllimi i një politike të tillë nuk duhet të jetë zëvendësimi i historisë shkencore me një narrativë zyrtare, por parandalimi i rishikimit të njëanshëm të historisë përmes krijimit të një baze të plotë, të verifikueshme dhe të qëndrueshme dokumentare. Republika e Kosovës duhet të jetë në gjendje të paraqesë në mënyrë profesionale dhe të argumentuar kontekstin e luftës, karakterin e konfliktit, përvojën e popullsisë civile, veprimtarinë e UÇK-së, ndërhyrjen ndërkombëtare dhe procesin e shtetndërtimit.

Prishtinë,
22 shtator 2026

KURTI TAKON ERDOGANIN: DO TË VAZHDOJMË TA MBËSHTESIM KOSOVËN PËR VENDIN E SAJ NË KOMUNITETIN NDËRKOMBËTAR

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Në nisje të punimeve të Javës së Nivelit të Lartë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, u takua me presidentin e Republikës së Turqisë, Recep Tayyip Erdogan. Kryeministri Kurti e falënderoi Presidentin Erdogan për mbështetjen e vazhdueshme të Turqisë përgjatë gjithë etapave të ndërtimit të shtetit të Kosovës, zhvillimit të tij, në diplomaci sikurse edhe për fuqizimin tonë ushtarak, bashkëpunimin në vënien e themeleve të industrisë sonë të mbrojtjes dhe përkrahjen për anëtarësimin në NATO. Po ashtu, ai shprehu mirënjohje për rolin shumëvjeçar të Turqisë në KFOR dhe për kontributin e rëndësishëm që ajo vazhdon të ketë për sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë, duke theksuar profesionalizmin e Gjeneralmajor Özkan Ulutaş gjatë dy mandateve të tij si

komandant i forcës së NATO-s në vendin tonë. Kosova dhe Turqia kanë vazhduar forcimin dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare me ç'rast ato arrijnë në vlerën prej 1 miliard dollarësh, me synimin që të rriten më shumë në të ardhmen. Po ashtu, janë rritur edhe investimet në Kosovë ku së fundmi kemi nisjen e fabrikës së re të municionit në Gjakovë dhe Parkun e Energjisë së Erës në Rahovec, që janë në bashkëpunim me kompani nga Turqia. Në takim kryeministri Kurti diskutoi edhe për aktgjykimin e padrejtë juridikisht dhe moralisht dhe të pasaktë historikisht dhe faktikisht, të shpallur javën e kaluar nga Dhomat e Specializuara në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, e që patjetër duhet të korrigjohet në Apel. Çështje tjetër, të cilën e ngritën kryeministri Albin Kurti bashkë me kryetaren e Preshevës, Ardita Sinani, ishte diskriminimi i vazhdueshëm dhe sistematik i



shtetit të Serbisë ndaj komunitetit shqiptar atje, nga pasivizimi i adresave, mosnjohja e diplomave e nënpërfaqësimi në secilin institucion shtetëror atje. Kryeministri thekoi se simetria e të drejtave të komuniteteve në vendet përkatëse është qasja dhe

mënyra e domosdoshme për trajtim të drejtë dhe barabartë. Kosova dhe Turqia do të vazhdojnë të thellojnë marrëdhëniet miqësore, sikurse do të rrisin e forcojnë edhe relacionet ekonomike e tregtare. Në përfundim të takimit,

kryeministri Kurti e ftoi presidentin Erdogan për një vizitë në Republikën e Kosovës. Ndërkaq në njoftimin e Zyrës së presidentit turk bëhet me dije se në takim u diskutua për marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Turqisë dhe Kosovës, si dhe për çështje rajonale dhe globale. Gjatë takimit, presidenti Erdogan deklaroi se të dyja vendet do të vazhdojnë të ndërmarrin hapa për rritjen e vëllimit tregtar në përputhje me potencialin e tyre dhe për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe industrisë së mbrojtjes. “Presidenti Erdogan rikonfirmoi se mbështetja e Turqisë për Kosovën në arritjen e vendit të saj të merituar në komunitetin ndërkombëtar do të vazhdojë, duke shtuar se Turqia mbështet gjithashtu dialogun ndërmjet vendeve të Ballkanit”, thuhet në njoftim. Erdogan gjithashtu e ftoi kryeministrin Kurti të marrë pjesë në Samitin e Liderëve të COP31, i cili do të mbahet në Turqi.

SHQIPËRIA I BASHKOHET NISMËS AMERIKANE PËR EKSPLORIMIN E HAPËSIRËS

TIRANË, 22 SHTATOR - Shqipëria është bërë vendi i 73-të që u bashkohet Marrëveshjeve Artemis, një nismë e udhëhequr nga NASA dhe Departamenti amerikan i Shtetit për bashkëpunimin ndërkombëtar në eksplorimin paqësor dhe të përgjegjshëm të hapësirës. Marrëveshja u nënshkrua të hënën në selinë e NASA-s në Uashington nga ministri i Shqipërisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ferit Hoxha. “Ky moment i shton një dimension të ri dhe të rëndësishëm partneritetit strategjik midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara”, tha Hoxha. Sipas tij, marrëveshja krijon mundësi të reja për të rinjtë shqiptarë dhe për bashkëpunim në teknologji dhe shkencë. Zëvendësadministratori i NASA-s, Matt Anderson, tha se marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara, të cilat datojnë më shumë se një shekull,

po zgjerohen edhe në fushën e eksplorimit hapësinor.

Çfarë janë Marrëveshjet Artemis?

Marrëveshjet Artemis janë një grup parimesh për bashkëpunimin ndërkombëtar në eksplorimin dhe përdorimin paqësor të hapësirës, me fokus të veçantë të Hënës, Marsi dhe trupat e tjerë qiellorë. Ato u krijuan në vitin 2020 nga NASA dhe Departamenti amerikan i Shtetit, së bashku me shtatë vende themeluese. Marrëveshjet nuk janë ligjërish detyruese, por përcaktojnë parime për bashkëpunimin dhe sigurinë gjatë aktiviteteve hapësinore. Vendet nënshkruese angazhohen për transparencë dhe shkëmbim të të dhënave shkencore, ndihmë për astronautët në raste emergjencash, mbrojtjen e vendeve me rëndësi historike në Hënë dhe shmangien



e ndërhyrjeve mes misioneve. Ato përfshijnë edhe masa për kufizimin e mbetjeve hapësinore. Mes 73 vendeve që janë pjesë e

nismës janë Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Australia, Kanadaja, India, Brazil,

Ukraina, Koreja e Jugut dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Pjesëmarrja në Marrëveshjet Artemis nuk kërkon që një vend të ketë program të vetin hapësinor. Nisma synon të krijojë një kuadër të përbashkët për bashkëpunimin mes vendeve në aktivitetet e ardhshme hapësinore. Shqipëria ka nisur tashmë të përdorë teknologjinë hapësinore për vëzhgimin e Tokës. Në janar të vitit 2023, ajo lëshoi satelitë Albania-1 dhe Albania-2 me një raketë Falcon 9 të kompanisë SpaceX nga Qendra Hapësinore Kennedy në Florida. Nënshkrimi i Marrëveshjeve Artemis i mundëson Shqipërisë të jetë pjesë e këtij kuadri ndërkombëtar të bashkëpunimit në eksplorimin hapësinor dhe të zhvillojë bashkëpunime të ardhshme me NASA-n dhe vendet e tjera nënshkruese. Në korrik të vitit 2026, Marrëveshjet Artemis iu bashkua edhe Serbia.

FSK-ja avancon kapacitetet teknike për mirëmbajtjen e automjeteve HMMWV me mbështetjen amerikane

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Në kuadër të zhvillimit dhe avancimit të vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës, është realizuar trajnimi “Maintenance Event”, në objektin e SMAR-it, në Aeroportin e Gjakovës. Trajnimi u zhvillua me pjesëmarrjen e pjesëtarëve të FSK-së dhe me mbështetjen e pjesëtarëve të Gardës Kombëtare të Ajova-s, SHBA, duke ofruar mundësi për shkëmbim të

përvojave dhe avancim të njohurive teknike në mirëmbajtjen e automjeteve HMMWV. Gjatë trajnimit, pjesëtarët e FSK-së zhvilluan aftësi praktike në inspektimin, mirëmbajtjen, diagnostikimin dhe riparimin e sistemeve kryesore të automjeteve HMMWV, me fokus të veçantë në transmisionin, sistemin e derivateve dhe sistemet elektronike. Një komponent i rëndësishëm i

trajnimit ishte edhe zhvillimi i kapaciteteve të instruktorëve të FSK-së, duke krijuar mundësi për bartjen e njohurive dhe përvojave të fituara tek pjesëtarët e tjerë të Forcës. Ky aktivitet përfaqëson një tjetër hap në ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të FSK-së, rritjen e efikasitetit në mirëmbajtjen e mjeteve dhe forcimin e bashkëpunimit të qëndrueshëm me Gardën Kombëtare të Ajova-s.



Kurti takon drejtoreshën menaxhuese të FMN-së, diskutojnë për bashkëpunimin

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti ka takuar në Nju-Jork drejtoreshën menaxhuese të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Kristalina Georgieva, me të cilën ka diskutuar për partneritetin e deritanishëm me Kosovën. "Agjenda jonë e reformave synon krijimin e vendeve më të

mira të punës, veçanërisht për të rinjtë dhe gratë, përmes rritjes së produktivitetit, investimeve dhe eksporteve, si dhe rritjes së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore. Në këtë drejtim, prioritet për Qeverinë mbetet zgjerimi i programit tonë SuperPuna për Gratë, si dhe vazhdimi dhe përmirësimi i

sistemit të arsimit dual. Gjatë këtij viti, Kosova shënoi rritje ekonomike prej 5.4% në tremujorin e parë dhe 4.1% në tremujorin e dytë", ka thënë Kurti pas takimit. Ai ka treguar se biseduan edhe për sfidat me të cilat po përballen vendet në mbarë botën, përfshirë rritjen e

çmimeve të naftës dhe krizën energjetike, si dhe për mekanizmat dhe masat që nevojiten për t'i përballuar këto sfida. "E falënderova znj. Georgieva për bashkëpunimin e vazhdueshëm me FMN-në, të cilin presim ta thellojmë dhe diversifikojmë edhe më tej në këtë mandat", ka deklaruar Kurti.



HEKURUDHA E SË ARDHMES, NJË VIZION STRATEGJIK PËR KOSOVËN 2035



Safet GËRXXHALIU

Të debatohet në këto kohë të mungesës së stabilitetit politik dhe të funksionimit normal të institucioneve për projekte strategjike është paksa utopike. Por ardhmëria e Republikës së Kosovës është më e gjatë sesa e kaluara dhe duhet të kemi objektivat dhe strategji zhvillimore në interes të shtetit dhe qytetarëve të saj.

Krahas digitalizimit dhe Inteligjencës Artificiale, investimet në infrastrukturën rrugore, ajrore dhe hekurudhore duhet të jenë prioritet. Shqyrtimi i Masterplanit Hekurudhor të Kosovës deri në vitin 2035, të hartuar si një vizion strategjik për transformimin e Kosovës në një shtet me një sistem hekurudhor modern dhe të integruar, duhet të analizohet dhe të pranohet si një mundësi strategjike, në shumë dimensione, në interes të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës. Masterplani propozon ndërtimin dhe modernizimin e rreth 600 kilometrave të infrastrukturës hekurudhore deri në vitin 2035, të organizuar rreth këtyre shtyllave:

- Lëvizshmëri kombëtare me

frekuencë të lartë, sipas modelit zviceran, që lidh qytetet kryesore të Kosovës brenda 30 - 60 minutave;

- Lidhje ndërkombëtare me shpejtësi të lartë drejt Tiranës, për 2 orë; Shkupit, për 1 orë; si dhe drejt Stambollit dhe Evropës Qendrore;
- Integrimi i Kosovës me Korridoret 8, 5c dhe 4;
- Zhvillimi i lidhjes hekurudhore me Aeroportin e Prishtinës, i portit të thatë, zonave të lira ekonomike dhe qendrave industriale e logjistike;
- Lidhje hekurudhore shumë efikase me Shqipërinë dhe me hapësirën më të gjerë shqiptare;
- Hekurudha turistike që lidhin destinacionet kryesore malore të Kosovës; dhe

- Investime mbështetëse të sistemit hekurudhor në energji, infrastrukturë digjitale dhe pasuri të paluajtshme.

Objektivat kryesorë janë që infrastruktura hekurudhore:

- Të shndërrohet në një instrument të fuqishëm të zhvillimit ekonomik, i cili të mundësojë një rritje deri në 5% të nivelit të PBB-së, me ndikim të qëndrueshëm vjetor;
- Të forcojë kohezionin territorial;
- Të mundësojë integrimin strategjik kombëtar de facto;
- Të nxisë rritjen e produktivitetit dhe të investimeve;
- Të krijojë një treg kombëtar të integruar të punës; dhe
- Ta pozicionojë Kosovën si një qendër rajonale të transportit, industrisë dhe logjistikës.

Masterplani është konceptuar në kuadrin e një vizioni më strategjik dhe makro, me qëllim të forcimit të rolit udhëheqës të Shqipërisë dhe Kosovës në rajon. Dokumenti është konceptuar si një kornizë strategjike për diskutim me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe me partnerët e mundshëm ndërkombëtarë, institucionalë dhe financiarë. Aktualisht, po diskutohet ky dokument me disa institucione të rëndësishme amerikane, përfshirë USTDA-n, USDfC-n dhe Departamentin Amerikan të Shtetit. Do të ishte dëm i madh për ardhmërinë e Republikës së Kosovës që të mos shfrytëzohet edhe kjo mundësi që ofron ky Masterplan.

DHTIK KËRKON MASA LEHTËSUESE PËR BIZNESET DHE FERMERËT NGA RRIJTJA E ÇMIMEVE TË DERIVATEVE

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë ka shprehur shqetësimin për rritjen e sërishme të çmimeve të derivateve, e cila po shton presionin mbi bizneset, fermerët dhe konsumatorët, dhe po rrit kostot e operimit në pothuajse të gjithë sektorët e ekonomisë. Që nga fillimi i krizës, DHTIK ka kërkuar mbajtjen e një tryeze të përbashkët ndërmjet institucioneve dhe përfaqësuesve të komunitetit të biznesit, me qëllim që të analizohen ndikimet e rritjes së kostove dhe të prezantohen propozime konkrete për përballimin sa më të lehtë të situatës. "Megjithatë, deri më tani nuk ka pasur gatishmëri të mjaftueshme institucionale për realizimin e një takimi të tillë. Ndikimi i rritjes së çmimeve të derivateve është veçanërisht i ndjeshëm në një kohë kur bizneset vazhdojnë të përballen

me reduktime të energjisë elektrike. Për një pjesë të ndërmarrjeve, veçanërisht ato prodhuese, ndërprerjet e energjisë i detyrojnë të përdorin gjeneratorë për të vazhduar procesin e punës, duke krijuar shpenzime shtesë për blerjen e derivateve", është thënë në reagimin e DHTIK-së, duke shtuar se ndikimi është i drejtpërdrejtë edhe në sektorin e bujqësisë, pasi derivatet janë një input i domosdoshëm për fermerët, të cilët i përdorin për traktorët dhe makineritë bujqësore gjatë përgatitjes së tokës, mbjelljes, trajtimit dhe korjes. DHTIK ka vlerësuar se rritja e çmimit të derivateve përkthehet drejtpërdrejt në rritje të kostos së prodhimit bujqësor dhe mund të reflektohet në çmimet e produkteve, që ndikon më pas në pjesëmarrjen e tyre në tregun edhe ashtu të ngufatur nga importi.



"Rritja e çmimeve të derivateve të naftës, ka pasur ndikim të madh në ngritjen e vazhdueshme të çmimeve të konsumit dhe kostove të ndërtimit dhe çmimeve të prodhimit", thuhet në reagim. Në këtë situatë, DHTIK konsideron të nevojshme që institucionet të ndërmarrin masa të përkohshme dhe të targetuara për zbutjen e kësaj barre. "Na rajon ka kohë që shtetet kanë marrë

masa, sidomos në uljen e akcizës, por edhe masa tjera për të ndihmuar ekonominë dhe qytetarët. Andaj, duke e parë që çmimi i derivateve vazhdon të ketë ngritje të ndjeshme dhe që kriza në Lindjen e Mesme nuk duket se do të zgjidhet shpejtë, DHTIK kërkon që edhe institucionet e Kosovës të shqyrtojnë pa vonesë mundësinë e uljes së përkohshme të akcizës dhe masa lehtësuese për

sektorët më të prekur. Njëkohësisht, DHTIK propozon që Qeveria të përdorë edhe instrumente të tjera për të mbështetur ekonominë vendore, përfshirë stimulimin e konsumit të produkteve vendore. DHTIK propozon gjithashtu që të shqyrtohen skema të përkohshme mbështetjeje për bizneset që janë të detyruara të përdorin gjeneratorë për shkak të reduktimeve të energjisë, si dhe masa lehtësuese për fermerët, për të cilët derivatet përbëjnë një nga inputet kryesore të prodhimit", theksohet në reagimin për media. Në një periudhë kur bizneset po përballen njëkohësisht me kosto më të larta të energjisë, derivateve, transportit dhe inputeve të tjera, DHTIK konsideron se dialogu institucional me komunitetin e biznesit është i domosdoshëm për të gjetur zgjidhje praktike dhe të zbatueshme.

Mbyllet Konsullata e Përgjithshme e Kosovës në Strugë, shërbimet konsullore përqendrohen në Ambasadën në Shkup

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Ambasada e Kosovës në Maqedoninë e Veriut ka njoftuar se është mbyllur Konsullata e Përgjithshme në Strugë, duke bërë me dije se shërbimet konsullore përqendrohen në Ambasadën në Shkup. "Në bazë të Dekretit Nr.150/2025 të presidentes së Republikës së

Kosovës dhe në zbatim të Vendimit përcjellës Nr. Ref 261/2026 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, njoftojmë se është mbyllur Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Kosovës në Strugë, Republika e Maqedonisë së Veriut. Vendimi bazohet në vlerësimin e

dinamikës së këtij misioni konsullor dhe është në funksion të optimizimit të resurseve, në përputhje me qëllimet dhe nevojat e gjithmbarshme institucionale", ka njoftuar Ambasada e Kosovës në Maqedoninë e Veriut, duke theksuar se në Strugë do të vijoj prezenca me zyre e Konsullit të

Nderit të Republikës së Kosovës, i ngarkuar me rreth konsullor pikërisht në këtë qytet. "Ambasada jonë në Shkup - krahas detyrave diplomatike - do të vijojë ofrimin e shërbimeve konsullore për shtetasit tanë për tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut", theksohet në njoftim.



VITI 1941: KUR DREJTUESIT E VISEVE TË SANXHAKUT KËRKONIN MBROJTJE NGA TIRANA

Delegacione nga Bihori i Epërm dhe Rozhaja kërkonin mbrojtje, armë, shkolla dhe ndryshim të statusit territorial. Dokumentet hedhin dritë të re mbi orientimet politike të Sanxhakut pas shpërbërjes së Mbretërisë së Jugosllavisë.



Nga: Ismet AZIZI

Pranvera e vitit 1941 e gjeti Sanxhakun në një nga momentet më të pasigurta të historisë së tij moderne. Mbretëria e Jugosllavisë ishte shembur, territoret e saj po ndaheshin ndërmjet fuqive pushtuese, ndërsa popullsia lokale përballej me pyetjen se nën cilën administratë do të jetonte dhe kush do ta garantonte sigurinë e saj. Dokumente të botuara nga autorë të ndryshëm tregojnë se, në këto rrethana, drejtuesit lokalë të Bihorit, Rozhajës dhe viseve të tjera të Sanxhakut kërkuar zgjidhje në disa drejtime. Disa delegacione shkuan në Zagreb, të tjera në Tiranë. Kërkesat e tyre nuk ishin vetëm territoriale. Ato përfshinin mbrojtjen e popullsisë, armatimin, administratën, arsimin dhe ndihmën për vendbanimet e shkatërruara. Këto dokumente janë me interes të veçantë edhe për një debat që vazhdon në historiografi: a mund të përshkruhen të gjitha këto iniciativa thjesht përmes formulës së “Shqipërisë së Madhe” apo realiteti politik i vitit 1941 ishte shumë më kompleks?

Delegacioni i Bihorit të Epërm në Tiranë

Një dëshmi veçanërisht interesante gjendet në librin e Fehim Xhogoviqit [Džogović], Bijela knjiga žrtava Sandžaka 1941-1945 [Libri i Bardhë për viktimat e Sanxhakut (1941-1945)], vëllimi III, kushtuar komunës së Petnjicës. Duke iu referuar monografisë së Salija Adrovićit, Gornji Bihor [Bihori i Epërm], Xhogoviqi shkruan se një delegacion nga Bihori i Epërm shkoi në Tiranë për të kërkuar: “mbrojtje nga çetnikët

dhe, eventualisht, bashkimin e kësaj krahine me Shqipërinë”. Në delegacion përmenden Dule Agović, Smajo Cikotiq, Hajriz Hadroviq, Shuqo Hadroviq, Hasin Koqan, Meta Kozhar, Rashit Liqina, Mujo Mehović, Seno Novaliq, Nushko Ramdedović, Huso Skenderović, Neko Shabotiq, Hajradin Shkrijel dhe Salko Shkrijel. Po aq interesante është përgjigja që, sipas burimit, morën delegatët. Atyre iu tha se do të merrnin ndihmë, por se për bashkimin territorial nuk vendosnin ata dhe se duhej kërkuar një mënyrë për bashkëjetesë. Kjo dëshmi është e rëndësishme sepse tregon se qysh në vitin 1941 në Bihorin e Epërm dy probleme shfaqeshin të lidhura: siguria e popullsisë dhe statusi politik i territorit.

Rozhaja dhe 27 fshatrat e Sanxhakut

Një dokument edhe më i drejtpërdrejtë gjendet në materialet arkivore të botuara nga studiuesi Gjet Ndoj në librin Qeverisja e Shqipërisë gjatë Luftës II Botërore (1939-1944). Dokumenti mban titullin “Rivendikimet shqiptare të mbetun nën Mal të Zi” dhe lidhet me përfaqësues të Rozhajës dhe 27 fshatrave të Sanxhakut. Më 4 nëntor 1941 përfaqësuesit e tyre ndodheshin në Tiranë. Lista e kërkesave është jashtëzakonisht domethënëse. Ata kërkonin bashkimin e viseve të tyre me Shqipërinë, dërgimin e nëpunësve shqiptarë, hapjen e shkollave në gjuhën shqipe dhe dërgimin e 20 mësuesve. Kërkonin gjithashtu që viset e tyre të lidheshin administrativisht me nënprefekturën e Rozhajës. Por, kërkesa që tregon më qartë

gjendjen e sigurisë ishte ajo për armë: “Lusim nxetësisht që të na epen, sa më parë që të jetë e mundun, 1 500 pushkë me fishekë të mjaftueshëm”. Sipas dokumentit, armët kërkoheshin që popullsia të ishte e përgatitur për mbrojtjen e territorit. Përfaqësuesit kërkonin gjithashtu ndihmë për njerëzit që vuanin nga uria, mungesa e strehimit, të ftohtit dhe sëmundjet, si dhe ndihmë për rindërtimin e shtëpive të djegura. Në fund të dokumentit thuhet se delegatët, duke ardhur në Tiranë, kishin lënë popullsinë e tyre në kushte të vështira dhe nën kërcënimin e sulmeve të reja. Burimi është veçanërisht i rëndësishëm sepse Gjet Ndoj jep edhe referencën e dokumentit original: Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 149, Dosja 1184, fletët 24-26, 4 nëntor 1941.

Jo vetëm një orientim politik

Dokumentet e tjera të vitit 1941 tregojnë se Sanxhaku nuk kishte një orientim të vetëm. Fehim Xhogoviqi përmend edhe një delegacion prej pesë vetash që më 15 maj 1941 shkoi në Zagreb dhe paraqiti një peticion për lidhjen me Bosnjën, duke pretenduar se përfaqësonte dhjetë rrethe, ndër to Beranën, Bijello Polen, Sjenicën, Pazarin e Ri, Tutinin dhe Rozhajën. Kjo është shumë e rëndësishme. Do të ishte historikisht e pasaktë të thuhej se “Sanxhaku kërkonte Shqipërinë” ose, në drejtimin tjetër, se “Sanxhaku kërkonte Bosnjën”. Burimet dëshmojnë akterë të ndryshëm, orientime të ndryshme dhe interesa lokale që jo gjithmonë përputheshin. Pikërisht për këtë arsye dokumentet duhet të lexohen përpara se mbi to të

vendosen etiketat e historiografisë së mëvonshme.

Nga Bihori e Rozhaja te Sjenica dhe Bijello Pole


Në studimin e tij Stara Raška pod italijanskom okupacijom 1941-1943 [Rashka e Vjetër nën pushtimin italian, 1941-1943], historiani serb Milutin Živković [Živković] trajton këto zhvillime nën kornizën “prijësit myslimanë dhe ‘Shqipëria e Madhe’”. Por, vetë dokumentacioni që ai paraqet lejon një lexim më të diferencuar. Në një fazë të mëvonshme, Bedri Pejani propozonte krijimin në Kosovë të një force prej 120-150 mijë njerëzish dhe zgjerimin e kufirit të shtetit shqiptar në mënyrë që në të të përfshiheshin i gjithë rrethi i Mitrovicës, Sjenica, Rozhaja dhe Bijello Pole. Edhe këtu duhet bërë një dallim: dokumenti përmend Bijello Polen, jo Bihorin si emërtim territorial. Megjithatë, përfshirja e Bijello Poles është me rëndësi për historinë e Bihorit për shkak të rolit të këtij qyteti si qendër administrative dhe urbane e lidhur ngushtë me krahinën.

Siguria dhe territori

Kur këto dokumente lexohen së bashku, del një pamje më komplekse e vitit 1941. Në Bihorin e Epërm kërkohej mbrojtje nga çetnikët dhe shqyrtoheshin mundësia e bashkimit me Shqipërinë. Në Rozhajë dhe 27 fshatra të Sanxhakut kërkoheshin 1 500 pushkë, shkolla shqipe, mësues, administratë, ndihmë humanitare dhe ndryshim i statusit territorial. Në pjesë të tjera të Sanxhakut kishte orientime drejt Bosnjës. Pra, kërkesat territoriale nuk mund të shpreheshin në një pyetje që

njerëzit e asaj kohe e konsideronin jetike: Kush do ta mbronte popullsinë pas shpërbërjes së Jugosllavisë? Kjo pyetje merr rëndësi të veçantë kur shihet nga perspektiva e asaj që do të ndodhte vetëm dy vjet më vonë. Në janar 1943, Bihori i Poshtëm do të përjetonte një nga trageditë më të rënda të popullsisë myslimane të kësaj hapësire gjatë Luftës së Dytë Botërore. Dokumentet e vitit 1941 tregojnë se frika nga sulmet dhe kërkimi i një sistemi më të gjerë mbrojtjeje kishin filluar shumë më herët. Prandaj, lidhja historike nuk duhet ndërtuar me formulën e thjeshtë se masakra e Bihorit krijoi orientimin politik drejt Kosovës ose Shqipërisë. Dokumentet tregojnë të kundërtën: orientimet politike ekzistonin më herët; përvoja e dhunës dhe pasigurisë ua shtoi atyre gjithnjë e më shumë dimensionin e mbrojtjes dhe të mbijetesës. Kjo është pikërisht arsyeja pse dokumentet e vitit 1941 meritojnë të rilexohen sot. Ato nuk na tregojnë vetëm ku dëshironin të përkisnin disa prej aktorëve të Sanxhakut. Na tregojnë edhe nga çfarë kishin frikë dhe çfarë kërkonin për të mbijetuar. /Telegafi/

Burimet kryesore: Fehim Džogović, Bijela knjiga žrtava Sandžaka 1941-1945, knj. III: Opština Petnjica (Podgorica, 2021), 23-24. Salija Adrović, Gornji Bihor (Berane, 1995), 100-101. Gjet Ndoj, Qeverisja e Shqipërisë gjatë Luftës II Botërore (1939-1944) (Tiranë: Fast Print, 2023), 169-170; AQSH, F 149, D. 1184, fl. 24-26, 4 nëntor 1941. Milutin Živković, Stara Raška pod italijanskom okupacijom 1941-1943, knj. I, 394-400.



QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

KFOR-i dhuron pajisje sportive për klubin FC Dardanët në Podujevë

PODUJEVË, 22 SHTATOR - Pjesëtarët e Komandës Rajonale-Lindje të KFOR-it kanë dhuruar pajisje sportive për futbollistët e rinj të klubit FC Dardanët në Podujevë. Aktiviteti është organizuar nga

ekipi për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak i kësaj komande. Pas dorëzimit të pajisjeve, pjesëtarët e KFOR-it kanë zhvilluar një ndeshje miqësore me futbollistët e rinj të klubit. Sipas KFOR-it, aktiviteti synon

forcimin e lidhjeve me të rinjtë dhe mbështetjen e zhvillimit të tyre. "Kjo nismë dëshmon përkushtimin e vazhdueshëm të KFOR-it për bashkëpunim me partnerët lokalë", ka njoftuar KFOR-i.



KOMBËTARJA E KOSOVËS NIS PËRGATITJET PËR LIGËN E KOMBEVE ME MESAZH TË FUQISHËM: DREJTËSI PËR ÇLIRIMTARËT

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Kombëtarja e Kosovës ka nisur përgatitjet për sfidat e radhës në kuadër të Ligës së Kombeve, por dita e parë e grumbullimit është shoqëruar edhe me një mesazh mbështetjeje për drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqi të cilët janë dënuar nga gjykata e shkallës së parë në Hagë. Në ditën e parë të grumbullimit, futbollistët që kishin angazhime me klubet e tyre kanë zhvilluar program rigjenerues në palestër, ndërsa pjesa tjetër e ekipit ka zhvilluar seancën stërvitore në stadiumin "Fadil Vokrri". Para dhe gjatë stërvitjes, Kombëtarja e Kosovës dhe Federata e Futbollit të Kosovës i



janë bashkuar mesazhit të mbështetjes për drejtuesit e UÇK-së. Futbollistët dhe stafi kanë

mbajtur të veshura bluza me mesazhet: "Drejtësi për çlirimtarët" dhe "Jo në emrin tim", duke përcjellë kështu një mesazh



të drejtpërdrejtë solidariteti. Kështu, krahas nisjes së përgatitjeve për ndeshjet e Ligës së Kombeve, dita e parë e

grumbullimit të "Dardanëve" është shënuar edhe nga mbështetja publike për drejtuesit e UÇK-së.

TAULANT XHAKA NË MBROJTJE TË GRANITIT: MOS HARRONI SA KRENARI KA TREGUAR PËR ZVICRËN



BERNË, 22 SHTATOR - Taulant Xhaka ka reaguar në mbështetje të vëllait të tij, Granit Xhakës, pas kritikave të shumta të drejtuar ndaj kapitenit të Zvicrës. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Taulanti ka theksuar se gabimet janë pjesë e jetës dhe se askush nuk është i pagabueshëm, duke kërkuar që kontributi i Granitit për kombëtaren zvicerane të mos harrohet. "Mos harroni kurrë atë që Granit Xhaka, vëllai im, ka dhënë ndër vite për Zvicrën. Sa shumë zemër, pasion dhe krenari ka treguar për këtë vend dhe për këtë fanellë", ka shkruar ai. Taulant Xhaka u është drejtuar

edhe gazetarëve dhe kritikëve, duke theksuar se të gjithë njerëzit mund të bëjnë gabime. "Edhe ju keni bërë gabime në jetën tuaj. E rëndësishme nuk është që një njeri të bëjë gabim, por të qëndrojë pas tij, ta pranojë dhe të nxjerrë mësim. Vëlla, jam krenar për ty. Kam qëndruar pas teje, qëndroj pas teje dhe gjithmonë do të qëndroj, çfarëdo që të ndodhë. Familja mbetet familje, në ditë të mira dhe në ditë të vështira", ka shkruar Taulant Xhaka. Reagimi i Taulantit vjen në një moment kur Granit Xhaka ka pranuar se kishte blerë një certifikatë të vaksinimit kundër Covid-19.

Betisi në garë për sulmuesin Lutfi Dalipi


Bernë, 22 shtator - Forma e mirë e sulmuesit Lutfi Dalipi në Superligën zvicerane ka tërhequr vëmendjen e disa skuadrave të njohura në Evropë. Real Betisi ka shprehur interesim për shërbimet e sulmuesit, i cili është i huazuar

te Vaduz nga Young Boys. Sipas raportimeve, skautët e Betisit e kanë përcjellë nga afër Dalipin, të cilin po e shohin si përforcim për të ardhmen dhe synojnë transferimin e tij vitin e ardhshëm. 20-vjeçari ka kontratë me

Young Boys deri në vitin 2030, ndërsa klubi zviceran është i gatshëm ta shesë për një ofertë prej 2 deri në 3.5 milionë eurosh. Megjithatë, përveç Betisit, edhe disa klube të tjera po e monitorojnë nga afër Dalipin,

përfshirë Fiorentinën nga Italia dhe Bragën nga Portugalia. Në 12 ndeshje zyrtare në sezonin aktual, Dalipi ka shënuar katër gola dhe ka dhënë tetë asistime për Vaduzin. Së fundmi, ai është ftuar edhe nga Kombëtarja U21 e Zvicrës.





N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail..contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Na osnovu odredbi člana 21, tačke 21.4 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i na osnovu člana 17 Statuta, Upravni odbor N.P.L. PALATI I RINISE AD, od 11.09.2026. godine, na osnovu Odluke Br. 1/2058 objavljuje ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje jedne (1) pozicije

1. Naziv radnog mesta: Generalni savetnik - Sekretar preduzeća
Lokacija: Priština.

Preduzeće: N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini.

Odgovoran: Upravnom odboru.

Mandat: 3 godine

Koeficijent: 5.9

2. Generalni savetnik - Sekretar preduzeća ima sledeće dužnosti i odgovornosti: Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove iz člana 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) nisu, ili u bilo kom trenutku tokom trideset šest (36) meseci pre datuma podnošenja zahteva nisu bili, direktori Upravnog odbora relevantne kompanije i (iv) imaju neophodno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju; Svako lice koje želi da bude razmatrano za poziciju direktora mora takode ispunjavati sledeće uslove stručne podobnosti:

- Posedovati univerzitetsku diplomu - Pravni fakultet (diplomirani pravnik ili master pravnih nauka);
- Posedovati najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti korporativnog upravljanja ili kompanijskog prava;
- Ispunjavati kvalifikacione uslove iz člana 17.1 i ispunjavati kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i izmene ZJP br. 04/L-111, član 13;

- Sposobnost za timski rad;
- Posedovati dobre komunikacijske veštine;
- Posedovati radnu etiku i integritet.
- Posedovati računarske veštine;
- Znanje engleskog jezika (poželjno);
- Dokazi o drugim znanjima i dostignućima biće uzeti u obzir i procenjeni u skladu sa relevantnošću za posao;
- Biti osoba sa visokim integritetom i ispunjavati sve uslove podobnosti utvrđene članom 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 i relevantnim izmenama, Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija br. 06/L-011, kao i drugim relevantnim pozitivnim normama.

3. Generalni savetnik – Sekretar kompanije ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Osigurati da se poštuju procedure Odbora, uključujući organizaciju sastanaka Odbora, odbora Odbora i akcionara, uključujući (u saradnji sa predsednikom) pripremu i distribuciju dnevnog reda;
- Voditi registar akcionara;
- Koordinirati sa Izvršnom komisijom pripremu materijala za sastanke Odbora direktora;
- Voditi zapisnike sa sastanaka Odbora direktora i Odbora za reviziju (osim ako njihovi predsednici ne zahtevaju drugačije) i evidentirati ih u zapisnicima;
- Distribuirati zapisnike direktorima i akcionarima;
- Obavljati zvaničnu registraciju promena koje zahteva zakon, evidentirajući ih u Kosovskom registru trgovačkih društava i trgovačkih imena;
- Prema uputstvima predsednika, odgovornosti Sekretara uključuju obezbeđivanje nesmetanog protoka informacija unutar Odbora i njegovih odbora i između Odbora i višeg menadžmenta Kompanije;
- Saveti i usluge Sekretara biće dostupni svim direktorima i biće odgovoran Odboru za obezbeđivanje usklađenosti sa procedurama Odbora;
- Prati pravne promene koje se odnose na Društvo tako što obaveštava Upravni odbor i rukovodstvo Društva o promenama i priprema neophodna uputstva za rukovodstvo Društva. Takođe se bavi i drugim pitanjima korporativnog upravljanja po potrebi.

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog fonda za penzijsku štednju, i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili u obavezi da plaćaju ovoj instituciji);
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa veb stranice Kompanije;
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak podnetih dokumenata.

5. Rok za konkurs:

Javni konkurs je otvoren u periodu od 30 (trideset) dana od 11.09.2026 do 10.10.2026. Zainteresovana lica mogu podneti svoje prijave sa ostalom relevantnom dokumentacijom na imejl adresu: burimetnjerezore@pallatirinise.com Obrazac za prijavu i izjava pod zakletvom mogu se preuzeti sa veb stranice N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini na <http://www.pallatirinise.com/> ili se mogu dobiti u kancelarijama Kompanije.

6. Napomena:

Kandidati sa nepotpunom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van roka za konkurs biće odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju navedene kriterijume i koji su uvršteni u uži izbor.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Lisi Group” SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 810845167 bënë ulje të kapitalit nga 140,000.00 në 1000.
- Trim Rezniqui shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Vjosa (Jusuf) Gradinaj, shpall të pavlefshme certifikatën e dhënies së Provimit të Jurisprudencës, me nr. 91/2017, të lëshuar në Prishtinë më 13.03.2017, për provimin e jurispru-dencës të dhënë më 31.01.2017, nga Ministria e Drejtësisë.
- Vjosa Jusuf Gradinaj shpall të pavlefshme diplomën LL.M. (Master) në Kontrata dhe të Drejtën Komerciale, në emër të, nr. 1689, të lëshuar më 27.02.2018, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” – Fakulteti Juridik.
- “Master Build SRL Dega në Kosovë” shpall të pavlefshme certifikatën e biz-nesit me nr. Unik Identifikues: 811932583.
- Thot Ratkoceri shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “28 Nëntori” shkolla Teknike Prishtinë.
- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.
- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi “ Prizren.
- Trim Rezniqui shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.
- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Sebastjan Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.

REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS

IAAP "LASGUSH PORADECI" KIJEVË

Datë: 21/09/2026

Nr. Prot. 1/159-26

IAAP "Lasgush Poradeci" Kijevë

Adresa: Rruga "Imer Krasniqi" pn.

shmplaspushporadeci@gmail.com

Bazuar në UA NR. 02/2016 të MASHT, për aktivitetet jashtëshkolllore, IAAP "Lasgush Poradeci" në Kijevë shpallë:

ofertë për ekskursion

(Ekskursion 5 ditor jashtë vendit - Shqipëri)

IAAP "Lasgush Poradeci" në Kijevë shpallë ftesë për oferta për përzgjedhjen e agjensionit të udhëtimit dhe akomodimit për organizimin e Ekskursionit 5 ditor në Republikën e Shqipërisë me maturantët për vitin shkollor 2026/27

Kohëzgjatja e ekskursionit do të jetë 4 netë / 5 ditë, me pansion të plotë.

Agjensioni turistik duhet ti plotësojë këto parakushte:

1. Kompania (agjensioni) turistik duhet të jetë i licensuar,

2. Të ketë fletëdëshminë e kontrollës teknike të autobusëve sipas procedurave ligjore,

3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve,

4. Kompania (agjensioni) turistik duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendorë të ngasësve të autobusëve,

5. Kompania (agjensioni) turistik duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe të ketë dëshmitë (cërtifikatë pune dhe diplomë të mjeksisë) që i shoqëron nxënësit,

6. Kompania (agjensioni) turistik duhet të ketë dokumentacionin (licensën) e akreditimit të ushqimeve në Shqipëri të nënshkruar dhe të vulosur nga pronari i hotelit,

7. Kontrata në mes të hotelit dhe Kompanis (agjensionit) turistik,

8. Kompania (agjensioni) turistik duhet të prezantojë menynë ditore të ushqimit për secilën ditë të qëndrimit në Shqipëri të nënshkruar dhe të vërtetuar nga pronari i hotelit,

9. Një fletë konfirmim të rezervimit të hotelit përkatës të vërtetuar në mes të kompanisë turistike dhe hotelit me datë të caktuar,

10. Licensa e ballos e vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit, ku nxënësit do të argëtohen,

11. Vertetim i ATK-së,

12. Hoteli ku bëhet akomodimi i nxënësve duhet të ketë shërbimin e sigurimit fizik dhe profesional,

13. Agjensioni duhet ti mbulojë shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumente historike,

14. Të kihet parasysh numri i nxënësve të vendosur nëpër dhoma.

Kategorizimi do të bëhet në bazë të kriterëve dhe sigurisë ku dhe do të vendoset për ofertën dhe vendin (hotelin) e vendosjes së nxënësve, nga komisioni përkatës ditën e hapjes së ofertave.

VËREJTJE: OFERTAT TË CILAT NUK I PËRMBUSHIN KRITERET E KËRKUARA NUK DO TË MERREN NË SHQYRTIM.

- Afati i aplikimit është 7 ditë nga dita e shpalljes së ofertës,

- Ofertat pranohen në sportelet e DKAË – së në komunën e Malishevës,

- Hapja e ofertave do të bëhet në ditën e fundit të aplikimit duke filluar nga ora 14:00 në shkollë.

Kijevë: 21/09/2026

Ud. Drejtori. Msc. Burim Gashi

KIJEVE
MALISHEVE

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “NORA SOLAR ” Sh.p.k., Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor për Parkun solar fotovoltaik 1 MWp – mbi kulm te objektit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.11.2026 në ora 13:30 ne amjentet e Shkolles Fillore dhe te Mesme te Ulët (SHFMU) “Ditët e Minatorit”, Kishnicë – Graçanicë, do të organizohet debat publik nga “NORA SOLAR ” Sh.p.k., Fushë Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

https://eu-central-1.protection.sophos.com?d=zoom.us&u=aHR0cHM6Ly91czA0d2ViLn timer 20udXMvai80NTQ5MzQ0NDk1P3B3ZD1HYktjb2NjU1d4MzIzM2U0UUy3UHNBa0NNM2J2S2ZyUHQ==&i=NjY1ZjIjOWVlZmMxZjE3Nzc3ZW MxNjRi&t=b3FBYUcxaFc0MVViMG1ya2xod2gxK3RmWThwWUZOVFNLUmlWNnE1NEF5Yz0=&h=82314f8c335249819ac6c5642720384e&s=AVNPUEhUTONFTkNSWVBUSVaTRAueU-vNbNdW92a0FAisFOgf0Rln55_29at16bUHiQ

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “NORA SOLAR ” Sh.p.k., Fushë Kosovë, për Pëlqim Mjedisor për Parkun solar fotovoltaik 1 MWp – mbi kulm te objektit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin “Xhema 4 F” SH.P.K. Piranë, Pizren, kërkesa me nr. prot. 26/331/MMPH për t’u pajisje me Leje Mjedisore, për Bazën për prodhimin e betonit në Krushë të Vogël - Prizren, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t’u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 22.10.2026, në ora: 11:00, në hapësirat e Administratës në Komunën e Prizrenit, do të organizohet debat publik nga operatori “Xhema 4 F” SH.P.K. Piranë, Pizren, kërkesa për Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/331/MMPH, për Bazën për prodhimin e betonit në Krushë të Vogël - Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

Linku për Zoom:

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxa dVorQT09>

Linku i Komunës së Prizrenit:

Linku i gazetës ditore:

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,
“XHEMA 4F” SHPK



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Pristina - Municipality Of Prishtina

SHML "Dr.Ali Sokoli"



SHML "Dr.Ali Sokoli"

Nr.812, dt.22.09.2026

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 02/2016 për aktivitete jashtëshkollore, SHML "Dr.Ali Sokoli" shpall këtë :

FTESË PËR OFERTË

Për përzgjedhjen e agjencisë turistike për organizimin dhe realizimin e ekskursionit për maturantët e vitit 2026/2027, në Republikën e Shqipërisë.

I. Infomata të përgjithshme:

- Ftesa për ofertë mbetet e hapur shtatë (7) ditë nga data e publikimit të ftesës më dt.22.09.2026 deri më dt.29.09.2026.
- Kohëzgjatja e ekskursionit dhe qëndrimit në Shqipëri do të jetë katër (4) ditë apo tre (3) bujtje. Në ditën e katërt bëhet kthimi për në Prishtinë.
- Numri i nxënësve që do të udhëtojnë për në Shqipëri do të jetë 172 nxënës + 9 stafë gjithsej (181), Evidente mund të jetë se numri mund të ndryshoj

II. Kriteret për ofertuesin

Agjencia turistike duhet:

- Të jetë e licencuar dhe të ushtrojë veprimtarinë në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Të sigurojë autobusë të përshtatshëm, komfort dhe me klimë;
- Të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm për kontrollin teknike të automjeteve;
- Të sigurojë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës;
- Të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Të sigurojë përkujdesje shëndetësore për nxënësit gjatë ekskursionit (certifikatë pune dhe diplomë e licencë valide të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Të ofrojë të gjitha shërbimet e specifikuar në ofertë dhe kontratë.
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar ka sallën e licencuar të ushqimit dhe ofron tre (3) porcione të plota të ushqimit të cilat duhet të jenë cilësore e të listuara dhe të paraqitura me përshkrim dhe foto si meny.
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të posedon licencën për aktivitete të lira dhe argëtim për nxënësit (ballo);
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të ofron dëshmi se hoteli i rezervuar të mos shërben pije alkoolike;
- Operatori ekonomik (agjencia) duhet të siguron dëshmi për rezervimin e hotelit në datat e caktuara, i cili hotel duhet të ofron siguri 24 orë për nxënësit dhe personelin përcjellës.
- Lirimi deri në tre (3) përqind (%) e numrit të pjesëmarrjes së nxënësve në ekskursion me gjendje të vështirë ekonomike, që përcaktohet nga Këshilli organizativ i ekskursionit.

III. Dokumentacioni që duhet të dorëzohet

Agjencia turistike ofertuese duhet të paraqesë:

- Licencën e vlefshme të agjencisë turistike;
- Certifikatën/dokumentacionin për transportin e udhëtarëve;
- Dëshminë për kontrollin teknik të automjeteve;
- Dokumentacionin që dëshmon rregullsinë dhe përshtatshmërinë e autobusëve për transportin e nxënësve;
- Të dhëna për numrin dhe kapacitetin e autobusëve, së paku (3) që do të angazhohen e që janë në pronësi të agjencionit;
- Dëshmi për gjendjen fizike dhe mendore të ngasësve të autobusëve, sipas kërkesave ligjore;
- Të dhëna për sigurimin e përkujdesjes shëndetësore gjatë ekskursionit, përfshirë emrin dhe dokumentacionin për personin/mjekun përgjegjës;
- Listën e së paku pesë (5) hoteleve ku operatori ofron shërbime të akomodimit e që duhet të jenë në qytetin/zonën e njejtë (Përzgjedhja e hotelit bëhet nga KD, pas shpalljes së fituesit)
- Numrin e nxënësve për dhomë dhe kushtet e akomodimit, duhen të jenë dy deri në tre nxënës për dhomë.
- Të dhëna për vendet kulturore-historike që do të vizitohen dhe rëndësinë e vizitave;
- Kontaktin e personit përgjegjës në hotel, adresën dhe numrin e telefonit;
- Çmimin total për nxënësin e çmimin përfundimtar të ofertës, me specifikimin e shërbimeve të përfshira;

IV. Afati dhe mënyra e dorëzimit të ofertave

- Ftesa për ofertë do të jetë e hapur shtatë (7) ditë nga data e publikimit të ftesës për ofertë. Data e publikimit 22.09.2026, Afati i fundit për dorëzimin e ofertave 29.09.2026;
- Ofertat duhet të dorëzohen në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës në sportelin nr.5 drejtorar Drejtorisë së Arsimit në zarf të mbyllur, me shënimin: "OFERTË PËR EKSKURSIONIN E NXËNËSVE – Shml "Dr.Ali Sokoli"
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk hapen dhe nuk shqyrtohen;
- Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të dorëzuara bëhet nga Komisioni përkatës në Drejtorinë e Arsimit duke respektuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara në udhëzimin përkatës;





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina

SHML "DR.ALI SOKOLI"



SHKOLLA E MESME E LARTË "DR.ALI SOKOLI"

Nr.817, dt. 22.09.2026

AGJENDA E EKSKURSIONIT

Datat parashihet të jenë: 05,06,07 Tetor 2026 tri netë (bujte), dhe data 08.10.2026 kthimi.


Dita 1: Nisja nga Prishtina është në ora 7:30, Gjatë rrugës për në Durrës vizitohet qyteti i Shkodrës dhe Kalaja e Rozafës. Arritja në hotel bëhet rreth orës 18:00. Akomodimi në hotel, darka, muzikë dhe fjetja.

Dita 2: Mëngjesi nga ora 08:00-09:00. Zhvillojmë vizitë qytetit të Vlorës dhe Shtëpisë së Pavarësisë në Vlorë. Arritja në Hotel në ora 15:00. Dreka prej 15:00-16:00, darka prej 20:00-21:00, muzikë dhe fjetja.

Dita 3: Mëngjesi nga ora 08:00-09:00. Zhvillojmë vizitë qytetit të Beratit. Arritja në Hotel në ora 15:00. Dreka prej 15:00-16:00. Darka prej 20:00-21:00, muzikë dhe fjetja.

Dita 4: Mëngjesi nga ora 08:00-09:00. Kohë e lirë dhe dorëzimi i dhomave deri në ora 11:00. Dreka 12:00-13:00. Nisja për në Kosovë nga ora 14:00. Gjatë rrugës për në Kosovë vizitohet Tirana. Arritja në Kosovë bëhet rreth orës 20:00.





Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L